

Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

RAPORTI PËR KOSOVË 2014



Ky projekt është financuar nga Bashkimi
Europian nëpërmjet Instrumentit të BE-
së për Ndhimën e

Para-antarësimit (IPA) Instrumentit për
Shoqëri Civile (CSF)

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky Raport i Monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan – Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim”

Partner udhëheqës:

Rrjeti Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2, 1000-Shkup, Maqedoni

Tel.: +389 (0)2 614 42 11

www.balkancsd.net

Partner zbatues për Kosovë:

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Fazli Grajqevci 4/a, 10000, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 248 636; 248 643

www.kcsfoundation.org

Ky raport është shkruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe ekipi përgjegjës i përbërë nga:

Taulant Hoxha - autor


Besnike Koçani – hulumtuese

Dren Puka – hulumtues

Rina Dragidella – ndihmës hulumtuese

Nart Orana - ndihmës hulumtues

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit European dhe Trustit Ballkanik për Demokraci. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European apo Trustit Ballkanik për Demokraci.



BALKAN CIVIL SOCIETY DEVELOPMENT NETWORK



Acquis i shoqërisë civile të Ballkanit
Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim
Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

RAPORTI PER KOSOVE 2014



Projekt i financuar nga BE-ja

Përmbajtja

Përmbajtja

Përmbledhje e përgjithshme	3
Hyrje.....	8
Metodologjia.....	13
Të gjeturat dhe rekomandimet.....	15
Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive	15
Nënfusha 1.1.: Liria e asociimit.....	15
Nënfusha 1.2.: Liritë e ndërlidhura	19
Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve.....	21
Nënfusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre	21
Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore	23
Nënfusha 2.3.: Burimet njerëzore.....	25
Fusha 3: Marrëdhëniet Qeveri-OShC.....	28
Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim	28
Nënfusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes	30
Nënfusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve.....	34
Të gjeturat dhe rekomandimet (forma tabelore).....	36
Burimet e përdorura dhe faqe të dobishme.....	58
Shtojca 1 – Lista e të intervistuarve	60
Shtojca 2 – Pyetjet e intervistave.....	61
Shtojca 3 – Pyetësi i hulumtimit të organizatave	64

Përmbledhje e përgjithshme

1. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë

Viti 2014 në Kosovë ka qenë vit i zgjedhjeve. Përveç fushatës parazgjedhore, e cila veçse kishte filluar në pranverë, zgjedhjet e datës 8 qershor 2014 rezultuan me një ngërç të gjatë politik dhe me një krizë institucionale, e cila zgjati më shumë se 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe, kur përbërja e re e Kuvendit nuk arriti të themelohej, të gjitha nismat legislative dhe të politikave u pezulluan, dhe Qeveria vazhdoi së zbatuari vetëm funksionet e saj themelore. Tek në mesin e dhjetorit 2014, koalicioni i dy partive më të mëdha arriti të votojë përbërjen e re të Kuvendit dhe të themelojë Qeverinë e re, ndërsa puna normale e institucioneve qendrore vazhdoi tek në vitin 2015. Kjo është një nga arsyet kryesore pse vetëm pak zhvillime kanë ndodhur gjatë vitit 2014, dhe pse shumica e planeve fillestare për reforma, përfshirë ato në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile, u vonuan.

Korniza bazë ligjore për themelimin, regjistrimin dhe punën e OJQ-ve ka mbetur e pandryshuar, ndërsa zbatimi i saj është ende i pjesshëm. Një akt nënligjor për regjistrimin dhe punën e OJQ-ve, i miratuar gjatë vitit 2014, ka paraparë një numër të tërë procedurash që dalin nga Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ¹, edhe pse futja e dispozitave për pezullimin e OJQ-ve paraqet shkelle të legjislacionit primar. Në bazë të këtyre dispozitave, Departamenti për OJQ ka pezulluar 14 OJQ. OShC-të janë të lira të **kërkojnë fonde dhe t'i sigurojnë** ato nga burime të ndryshme vendore dhe të jashtme, edhe pse kufizimet e parapara në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit krijojnë vështirësi dhe janë kufizuese për OJQ-të. Pasi që **liria e tubimit** është e garantuar me ligj, OShC-të vazhdojnë t'i ushtrojnë këto të drejta lirshëm, edhe pse vetëm disa OShC kanë qenë të përfshira në organizimin e tubimeve paqësore gjatë vitit 2014. OShC-të kosovare kanë një qëndrueshmëri të pjesshme financiare dhe janë shumë të varura nga fondet e huaja. **Lehtësirat tatimore** për donatorët privatë vazhdojnë të jenë pjesë e kornizës ligjore, por fushëveprimi i kufizuar i lehtësirave dhe dispozitat me dykuptimësi nuk japin ndonjë stimulim për donatorët privatë në mënyrë që ata t'i përkrahin aktivitetet e OShC-ve. Përkundër deklaramëve politike mbi rregullimin e **fondeve publike për OShC-të**, nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret për vendosjen e procedurave dhe kritereve standarde për programimin, përzgjedhjen, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Shoqëria civile ende nuk është e përfshirë në asnjë **politikë të punësimit**, ndërsa aktivitetet për avancimin e **vullnetarizmit** janë shumë të kufizuara dhe të izoluar. **Trupat për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017** janë themeluar në fund të vitit 2014, ndërsa zbatimi konkret i aktiviteteve të Strategjisë ende nuk ka filluar. Korniza ligjore për **konsultimin e OShC-ve gjatë hartimit të ligjeve dhe politikave publike** nuk ka ndryshuar – kërkesat ekzistuese në nivel qeveritar nuk respektohen në plotëni, edhe pse ka mjaft raste kur OShC-të përfshihen në hartimin e ligjeve dhe të politikave. **Pjesëmarrja e OShC-ve në trupat ndërsektoriale** mbetet e pjesshme dhe ende nuk ka kritere standarde të përzgjedhjes. Gjatë vitit 2014 ka pasur raste të përzgjedhjes së hapur dhe transparente, ashtu siç ka pasur edhe procese të përzgjedhjeve jotransparente dhe shumë të kritikuara. Një numër nismash për **ofrimin e shërbimeve nga OShC-të** vazhdojnë të trajtojnë çështje të licencimit të shërbimeve sociale dhe të ofruesve të këtyre shërbimeve, duke tentuar rritjen e mundësive të OShC-ve në këto fusha. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve nga OShC-të është ende i kufizuar vetëm në disa shërbime sociale, ndërsa vazhdon të mos ketë **financim, procedura**

¹ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2764>

dhe standarde të duhura, përmes të cilave do të krijohet një mjedis i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve.

Sfidat kryesore lidhur me fushat e Matricës për të ardhmen e zhvillimit të shoqërisë civile janë: vlerësimi i nivelit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore dhe identifikimi i çështjeve për përmirësimin e dispozitave ligjore tek legjislacioni bazë për OShC-të për të mundësuar një qasje më vizionare të kornizës ligjore për shoqërinë civile; mbrojtja e parimeve të së drejtës jofitimprurëse nga nismat kufizuese që vijnë nga institucionet publike, si dhe heqja e kufizimeve ekzistuese ligjore në Ligjin kundër terrorizimit; moskuptimi i duhur i parimeve të funksionimit të sektorit të shoqërisë civile madje edhe nga institucionet që kanë për mandat të punojnë me këtë sektor; krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të përkrahjes shtetërore me qëllim që të sigurohet që projektet dhe nismat e OShC-ve të përkrahen në përzgjedhje, zbatim dhe raportim transparent dhe llogaridhënës; krijimi i një qasjeje të standardizuar rreth parimeve të bashkëpunimit të krijuara së fundi, e cila do të shfrytëzohej nga mbarë administrata publike; pranimi i shoqërisë civile si një ofruer i aftë i shërbimeve dhe hapja e sistemit të prokurimit publik për OShC-të. Shumica e këtyre sfidave trajtohen edhe në kuadër të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila është e paraparë të shërbejë si kornizë për nismat specifike, përmes të cilave trajtohen çështjet e caktuara. Derisa institucionet publike janë relativisht të hapura për hartimin e politikave dhe ligjeve të reja, zbatimi i legjislacionit në fuqi mbetet shumë problematik. Kjo është arsyeja pse - njëkohësisht me propozimin e ligjeve të reja dhe me ndryshimin e atyre ekzistuese - si shoqëria civile, ashtu edhe qeveria, duhet të ngulmojnë në krijimin e kapaciteteve të nevojshme dhe instrumenteve të rregullta të monitorimit të zbatimit të politikave dhe legjislacionit në fuqi.

2. Gjetjet kryesore

Gjatë viteve të fundit zhvillimi i shoqërisë civile gjithnjë e më shumë ka qenë i pranishëm në diskursin e një pjese mjaft të madhe të organizmave politik dhe institucional të vendit. Qëndrimi i pjesës më të madhe të zyrtarëve të shtetit është zhvendosur nga një indiferencë e madhe dhe nga bashkëpunimi ad-hoc dhe jotransparent në drejtim të rritjes graduale të interesimit dhe nevojës për të strukturuar bashkëpunimin me këtë sektor. Përkundër interesimit më të madh nga autoritetet publike për miratimin e dokumenteve sesa në zbatimin e tyre, janë vërejtur përmirësime të dukshme si në aspektin e dokumenteve kornizë, ashtu edhe në hapjen e institucioneve shtetërore drejt shoqërisë civile. Megjithatë për shkak të krizave të mëdha politike dhe mungesës së institucioneve qendrore të cilat karakterizuan pjesën më të madhe të vitit 2014, është vërejtur progres i vogël gjatë këtij viti dhe shumica e planeve fillestare për reforma janë vonuar. Prandaj në standardet e përfshira në raportin e vitit 2014, janë bartur disa prej gjetjeve dhe rekomandimeve nga viti paraprak. Mbetet të shihet nëse qeveria e re e themeluar në fund të vitit 2014 do të zotojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, si dhe vullnetin e nevojshëm politik për të avancuar edhe më tej ambientin për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

6 gjetjet më të rëndësishme nga raporti		Referencë	
1	Obligimet specifike për OJQ-të në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit kufizojnë funksionimin e lirë të OShC-ve dhe vejnë kushte të rënda për sigurimin e burimeve financiare.	Fusha	1
		Nënfusha	1,1
2	Iniciativa e vitit 2014 nga Departamenti për OJQ për harmonizimin e Ligjit për lirinë e asociimit në OJQ me dispozitat kufizuese të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit rrezikon veprimin e lirë të OShC-ve dhe i mundëson shtetit të ndërhyjë në veprimtarinë e brendshme të	Fusha	1
		Nënfusha	1,1

	OShC-ve.		
3	Lejimi i "pezullimit të OJQ-ve" nga një organ administrativ përmes akteve nënligjore ka mundësuar ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit në çështjet e brendshme të OShC-ve, siç dëshmohet me pezullimin e 14 OShC-ve menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave.	Fusha	1
		Nënfusha	1,1
4	Përkrahja shtetërore për OShC-të ende nuk ofrohet në mënyrë transparente dhe nuk shfrytëzohet në mënyrë llogaridhënese, përkundër një sërë zotimesh nga Ministri i Financave dhe zyrtarët e tjerë për rregullimin e kësaj fushe.	Fusha	2
		Nënfusha	2,2
5	Qasja strategjike e qeverisë për të bashkëpunuar me shoqërinë civile është ende në një fazë të hershme, pasi që zbatimi i Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile është vonuar në mënyrë të konsiderueshme, edhe pse është bërë një përparim në këtë fushë përmes krijimit të trupave të përbashkëta për zbatimin e Strategjisë nëpërmjet një angazhimi të përbashkët nga të dyja palët.	Fusha	3
		Nënfusha	3,1
6	Përfshirja e OShC-ve në vendimmarrje ende nuk është e standardizuar, dhe zbatimi i kufizuar i kërkesave ligjore aktuale nuk u mundësojnë OShC-ve të japin kontributin e tyre me kohë në shumë nisma politike dhe legjislative.	Fusha	3
		Nënfusha	3,2

3. Rekomandimet kryesore të politikave

Duke hyrë në një periudhë kur planifikohen reforma të mëdha në fushat kryesore të zhvillimit të shoqërisë civile, është thelbësore që të gjendet baraspesha e duhur ndërmjet hartimit të legjislacionit të favorshëm dhe investimit në mekanizmat ekzistues dhe të rinj për zbatimin e tij. Pjesët e fragmentuara të legjislacionit dhe praktikave ekzistuese duhet vendosur brenda një qasjeje koherente strategjike, duke u trajtuar horizontalisht drejt zhvillimit të shoqërisë civile. Strategjia e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile paraqet një platformë solide mbi të cilën duhet ndërtuar reformat, derisa nismat e tjera duhet të kenë parasysh drejtimin strategjik që parasheh ky dokument kornizë.

Nr.	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë	Referencë	
1	Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit duhet ndryshuar për të hequr të gjitha dispozitat kufizuese për OJQ-të, përfshirë kushtet për autorizimin paraprak për pranimin dhe pagesën e mjeteve, si dhe veprat penale për mosrespektimin e këtyre obligimeve.	Fusha	1
		Nënfusha	1,1
2	Departamenti për OJQ duhet të bashkëpunojë me të gjithë akterët relevant për rishikimin e Ligjit për lirinë e asociimit dhe zbatimin e tij, me synim të identifikimit të zbrazëtive ligjore dhe sfidave të zbatimit, si dhe duhet nisur një proces i ndryshimit të ligjit ekzistues në bazë të rezultateve të këtij rishikimi.	Fusha	1
		Nënfusha	1,1
3	Pavarësisht nga rishikimi i përmendur më lart, neni 18 i Rregullores së OJQ-ve, ku parashihet pezullimi i OJQ-ve nga Departamenti i OJQ-ve duhet të hiqet menjëherë.	Fusha	1
		Nënfusha	1,1
4	Siç rekomandohet edhe në Raportin e vitit 2013, duhet të iniciohet një sistem gjithëpërfshirës për financim publik, në bazë të objektivave të Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe në bazë të kriterëve, standardeve dhe procedurave të përcaktuara për të siguruar menaxhim transparent dhe llogaridhënës të fondeve publike për OShC-të. Pavarësisht nga sistemi gjithëpërfshirës, të gjitha informacionet për fondet publike të dhëna për OShC-të duhet të bëhen transparente.	Fusha	2
		Nënfusha	2,2
5	Qeveria duhet të iniciojë një zbatim më dinamik i Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, përfshirë krijimin e një sistemi monitorimi për	Fusha	3
		Nënfusha	3,1

	zbatimin e saj. Ngjashëm, Kuvendi i Kosovës duhet të përcaktojë mekanizmat konkret të bashkëpunimit dhe përfshirjes së OShC-ve në punën e Kuvendit, bazuar në Deklaratën e miratuar në vitin 2014.		
6	Akti normativ lidhur me standardet minimale për konsultimet publike në nivel Qeverie duhet të miratohet dhe zbatohet, bazuar në propozimet nga shoqëria civile.	Fusha	3
		Nënfusha	3,2

4. Rreth projektit dhe matricës

Ky Raport i monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile të Ballkanit-Fuqizimi i potencialit dhe i kapaciteteve të avokimit dhe monitorimit të OShC-ve”, i cili financohet nga BE-ja dhe Trusti i Ballkanit për Demokraci (BTD). Ky Raport monitorues është i pari i këtij lloji, i cili do të botohet çdo vit për së paku 48 muaj sa zgjatë projekti. Monitorimi bazohet në Matricën e monitorimit për ambientin e favorshëm lidhur me zhvillimin e shoqërisë civile, e cila është krijuar nga BCSDN dhe ECNL. Ky Raport është pjesë e raporteve për vende të ndryshme, përmes të cilave mbulohej 8 vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë². Gjithashtu është në dispozicion edhe Raporti monitorues për regjionin, ku përmbledhen gjetjet dhe rekomandimet kryesore për të gjitha shtetet, si dhe platforma në internet, ku jepet qasja në të dhënat e monitorimit për secilin vend dhe nënfushë, në faqen e internetit në vijim: www.monitoringmatrix.net.

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është identifikuar si thelbësore në mënyrë që ambienti ligjor të konsiderohet si përkrahës dhe i favorshëm për aktivitetet e OShC-ve. Matrica është e organizuar rreth tri fushave, ku secila ndahet në nënfusha: (1) Garancitë themelore ligjore të lirive; (2) Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve; (3) Marrëdhëniet në mes të Qeverisë dhe OShC-ve. Parimet, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të zhvillimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, si dhe larminë mes tyre. Ato bazohen në liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht, si dhe në praktikën më të mira rregullative në nivel të Bashkimit Europian dhe të vendeve europiane. Përmes kësaj Matrice tentohet identifikimi i situatës optimale në mënyrë që shoqëria civile të funksionoj dhe të zhvillohet në mënyrë të efektshme, dhe njëkohësisht tentohet të paraqitet një kornizë reale, e cila mund të respektohet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh se sfidat kryesore kanë të bëjnë me zbatimin, indikatorët janë të përcaktuar për të monitoruar gjendjen edhe në nivel të kornizës ligjore edhe të zbatimit praktik. Monitorimi dhe raportimi vjetor për vitin 2014 përqendrohet në (12) standarde bazë, të cilat janë monitoruar në të gjitha vendet e përfshira. Këto standarde bazë janë si në vijim:

1. Standardi 1.1.2: OShC-të punojnë lirshëm, pa ndërhyrjen e paarsyeshme të shtetit në drejtimin e dhe aktivitetet e tyre të brendshme;
2. Standardi 1.1.3: OShC-të lirshëm mund të kërkojnë dhe sigurojnë burime financiare për ta përkrahur veprimtarinë e tyre nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja;
3. Standardi 1.2.1: Përfaqësuesit e OShC-ve, qoftë individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e tubimit paqësor;
4. Standardi 2.1.1: Lehtësirat tatimore janë në dispozicion për burime të ndryshme të të hyrave të OShC-ve;
5. Standardi 2.2.1: Financimi publik është në dispozicion për zhvillimin institucional të OShC-ve, për përkrahje të projekteve dhe për bashkëfinancimin e granteve të BE-së dhe të granteve të tjera;
6. Standardi 2.2.2: Financimi publik shpërndahet në mënyrë të paraparë dhe transparente;
7. Standardi 2.3.1: OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë;
8. Standardi 2.3.2: Ekzistojnë politika dhe ligje përkrahëse për vullnetarizëm;

² Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

9. Standardi 3.1.2: Shteti, përmes funksionimit të institucioneve të tij, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektorin;
10. Standardi 3.2.1: Ekzistojnë standardet që mundësojnë përfshirjen e OShC-ve në vendimmarrje, që ua mundëson atyre dhënien e komenteve dhe kontributit me kohë;
11. Standardi 3.2.3: Përfaqësuesit e OShC-ve janë partnerë të barabartë në trupat ndërsektoralë dhe zgjedhen përmes kritereve dhe proceseve të përcaktuara qartazi;
12. Standardi 3.3.1: OShC-të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata shtetërore në baza të barabarta me ofruesit e tjerë të shërbimeve.

Përveç kësaj, për shkak të zhvillimeve specifike lidhur me themelimin e trupave për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, në Raportin për Kosovën të vitit 2014 është përfshirë edhe një standard shtesë për marrëdhëniet mes Qeverisë dhe OShC-ve (standardi 1 i nënfushës 3.1 – Shteti, përmes politikave dhe strategjive, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektorin).

Hyrje

1. Në lidhje me raportin e monitorimit

Përmes një procesi pjesëmarrës ku ishin përfshirë personalitete të shquara të shoqërisë civile, institucioneve publike, akademike, sektorit privat dhe medie, në vitin 2010 KCSF e ka definuar sektorin e shoqërisë civile në Kosovë si *“Hapësira shoqërore, jashtë familjes, shtetit, dhe tregut, e cila është krijuar nga veprimet individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet jo për përfitim, që nuk hyjnë në garë për pushtet, por për të avancuar interesat e përbashkëta.”*³. I përdorur për të gjitha studimet e KCSF-së që nga ajo kohë, ky definicion shfrytëzohet edhe për ta përcaktuar fushëveprimin e këtij raporti që nga zanafilla e tij në vitin 2013.

Thënë konkretisht, shoqëria civile në Kosovë përbëhet kryesisht nga organizata të regjistruara joqeveritare (OJQ), përderisa format tjerat të shoqërisë civile nuk janë të zakonshme. Edhe pse numri i tyre është në rritje, ende hasim në një numër shumë të vogël të shembujve të iniciativave të peregjistruara, ndërsa shumica e tyre krijohen në baza ad-hoc dhe nuk vazhdojnë të jenë aktive pasi që problemi/çështja konkrete të jetë zgjidhur. Për më tepër - edhe pse zyrtarisht zënë vend në kuadër të definicionit të shoqërisë civile – sindikatat shihen shumë rrallë si të tilla, dhe bashkëpunimi në mes të sindikatave të ndryshme dhe pjesës tjetër të shoqërisë civile është i kufizuar, ndërsa sindikatat rrallë janë pjesë e iniciativave dhe forumeve të shoqërisë civile. Bashkësitë fetare, në përgjithësi, nuk konsiderohen të jenë pjesë e shoqërisë civile. Mediet mund të konsiderohen të jenë edhe brenda edhe jashtë këtij sektori – shumica prej tyre janë të regjistruara si biznese private, mirëpo roli i tyre në çështje të demokratizimit mund të konsiderohet si pjesë e shoqërisë civile⁴.

Ky raport ka adresuar çështjet e shoqërisë civile në kuptimin e definuar më lartë si dhe përbrenda standardeve specifike të definuara⁵. Sidoqoftë, iniciativat apo çështjet e veçanta të cilat nuk konsiderohen patjetër brenda shoqërisë civile apo janë të mbuluara përmes standardeve të tjera gjithashtu janë marrë parasysh, në raste kur ato çështje apo iniciativa kanë ndikuar në masë të madhe në zhvillimin e shoqërisë civile apo në rastet e standardeve specifike të cilat janë pjesë e monitorimit. Ky raport mbulon zhvillimin gjatë vitit 2014, derisa një numër i proceseve të cilat janë inicuar më herët gjithashtu janë përcjellë në lidhje me progresin e tyre.

Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i bazës për monitorim dhe avokim në çështjet e lidhura me ambientin favorizues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel rajonal dhe kombëtar, si dhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OShC-ve në politikën e BE-së dhe procesin e anëtarësimit në nivel evropian dhe kombëtar.

2. Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

Raport i monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan – Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim” të financuar nga BE-ja dhe Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD). Ky raport i monitorimit është i dyti i llojit të tillë që do të

³ CIVICUS Indeksi i shoqërisë civile për Kosovë 2011, KCSF 2011.

⁴ Matrica monitoruese për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile – Raporti për Kosovën 2013, KCSF 2013.

⁵ Dymbëdhjetë (12) standardet themelore të monitoruara gjatë vitit 2014 janë standardet 1.1.2; 1.1.3; 1.2.1; 2.1.1; 2.2.1; 2.2.2; 2.3.1; 2.3.2; 3.1.2; 3.2.1; 3.2.3; 3.3.1, ndërsa standardi shtesë i monitoruar posaçërisht për Kosovën është standardi 1.3.1. Për më shumë, shih pjesën e përparme të Raportit.

publikohet për çdo vit për periudhën prej 48 muajve, sa do të jetë kohëzgjatja e projektit. Monitorimi është i bazuar në Matricën e monitorimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile. Ky Raport është pjesë e një vargu të raporteve kombëtare që mbulojnë 8 shtete në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi⁶. Një raport mbi monitorimin rajonal i cili përmbledh të gjeturat dhe rekomandimet për të gjitha shtetet dhe një platformë e internetit e cila ofron qasje në të dhënat e monitorimit për secilin shtet dhe nënfushë gjithashtu është në dispozicion tek adresa www.monitoringmatrix.net.

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore, ekzistenca e të cilave është identifikuar si e domosdoshme në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për veprimtarinë e OShC-ve. Ky e thekson faktin se mjedisi favorizues për zhvillim është një koncept kompleks, i cili përfshinë fusha të ndryshme dhe varet nga një numër i faktorëve dhe fazave të zhvillimit të shoqërisë dhe sektorit të shoqërisë civile.

Matrica nuk ka për qëllim t'i përshijë të gjitha çështjet e mjedisit të favorshëm. Më parë mund të themi se i thekson ato çështje të cilat ekspertët, në mendimin e tyre, i kanë vlerësuar se janë më të rëndësishmet për shtetet në të cilat ata veprojnë. Për këtë arsye, standardet dhe indikatorët janë formuluar duke pasur parasysh gjendjen e tashme të zhvillimit dhe larminë e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Këto janë nxjerrë nga përvojat e OShC-ve nëpër shtetet përkatëse, në aspektin e ambientit ligjor si dhe praktikave dhe sfidave me zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve është bërë duke marrë parasysh të drejtat dhe liritë e garantuara ndërkombëtarisht, si dhe praktikat më të mira në nivel të Bashkimit Europian dhe shteteve të Europës.

Matrica është e organizuar në tri fusha, secila e ndarë në nënfusha:

1. Garancitë themelore ligjore të lirive;
2. Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve;
3. Marrëdhëniet në mes të Qeverisë dhe OShC-ve

Fushat janë definuar përmes parimeve kryesore të cilat më tutje janë shtjelluar përmes standardeve specifike. Në mënyrë që t'u mundësohet OShC-ve, donatorëve apo palëve e tjera të interesuara të shqyrtojnë dhe monitorojnë ambientin ligjor dhe praktikat e zbatimit të tij, standardet më tutje janë shpjeguar përmes indikatorëve. Standardet e përzgjedhura për monitorim gjatë vitit 2014 janë në dispozicion në kapitullin e VI. - Të gjeturat dhe rekomandimet, përderisa Matrica e plotë është në dispozicion tek www.kcsfoundation.org, www.balkancsd.net dhe www.monitoringmatrix.net.

Zhvillimi i Matricës së monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile ishte pjesë e angazhimit të përbashkët të ekspertëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile nga organizatat anëtare dhe partnerët e BCSDN-së, si dhe me përkrahje strategjike dhe në nivel të ekspertizës nga ECNL. Ekipi i ekspertëve i përbërë nga 11 anëtarë ka pasur shtrirje në diturinë dhe përvojën e shumëllojshme joqeveritare dhe të OShC-ve, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe ka përfshirë ekspertë nga 10 shtete të Ballkanit. Puna në Matricë ka përfshirë punëtorin dhe punë on-line me ekspertët, e cila më pastaj është shqyrtuar me kujdes nga grupe të fokusit të palëve të interesuara dhe konsultime publike. Puna në zhvillimin e Matricës është përkrahur nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL, në kuadër të programit për mjedisin favorizues ligjor (LEEP)/grantet për inovacione ligjore, si dhe nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD).

3. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë

OShC-të kosovare mbulojnë një gamë të gjerë të fushave të aktiviteteve të tyre. Një numër i fushave gjithnjë tërheqin më shumë OShC dhe disa fusha tjera kanë rënie në numrin e OShC-vë të përfshira. Më herët, fushat kryesore të angazhimit të OShC-ve ishin të drejtat e grave, çështjet e pakicave dhe të rinisë. Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, puna e OShC-ve në çështjet e demokratizimit, siç është sundimi i ligjit në përgjithësi si dhe ato OshC që njihen si " OShC mbikëqyrëse/watchdog" janë duke e rritur

⁶ Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

prezencën e tyre. Për më tepër, ka një numër mjaft të madh të OShC-vë të cilat merren me çështje specifike siç janë të drejtat e njeriut (përfshirë të drejtat e komunitetit LGBT), rinia, të drejtat e grave, mjedisi, kultura, përfshirja shoqërore, etj.⁷

Përbrenda kësaj tërësie, zhvillimi i shoqërisë civile ka qenë temë diskutimi kryesisht përbrenda grupeve të vogla të shoqërisë civile, dhe vetëm kohëve të fundit kjo temë ka filluar të jetë e pranishme në diskursin e pjesës më të madhe të strukturave politike të shtetit. Gjatë viteve të fundit, qëndrimi i zyrtarëve qeveritarë ndaj zhvillimit të OShC-ve dhe dialogut civil është duke ndryshuar nga qëndrimi kryesisht indiferent dhe bashkëpunimi ad-hoc e jotransparent drejt një interesimi i cili gradualisht është në ngritje, si dhe nevojës për strukturimin e bashkëpunimit me tërë sektorin. Presioni i brendshëm nga OShC-të kosovare dhe theksi i vazhdueshëm që Bashkimi Europian e vë në rëndësinë e një sektori civil të zhvilluar ka rezultuar në ngritje të interesimit të institucioneve publike që të përfshijnë dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë civile përmes mekanizmave dhe instrumenteve të tyre.⁸

Derisa viti 2013 është shënuar si vit i miratimit të Strategjisë së parë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, në vitin 2014 Qeveria ka ndërmarrë hapat e parë konkret drejt themelimit të mekanizmave për zbatimin e Strategjisë. Me themelimin e Këshillit për zbatimin e strategjisë në pjesën e dytë të vitit 2014, gama e njësive qeveritare të përfshira në zhvillimin e shoqërisë civile është zgjeruar përtej Zyrës së Kryeministrit, për të përfshirë gjithashtu edhe një numër të ministrive të linjës. Për më tepër, me miratimin e Deklaratës për bashkëpunim me shoqërinë civile, Kuvendi i Kosovës, për herë të parë ka ndërmarrë një nismë formale të ndërlidhur me zhvillimin e shoqërisë civile.

Përkundër këtyre hapave pozitivë, shumica e standardeve për një ambient të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile ende nuk janë plotësuar. Për një numër të fushave, siç janë liria e asociimit dhe përfshirja e shoqërisë civile në vendimmarrje, korniza ligjore është relativisht pozitive, mirëpo zbatimi i saj është i kufizuar. Për fusha të tjera, siç është përkrahja shtetërore për shoqërinë civile apo angazhimi i OShC-ve në ofrim të shërbimeve, korniza ligjore pothuajse nuk ekziston apo është në fazat shumë të hershme të zhvillimit, dhe për këtë arsye praktika është ad-hoc dhe nuk është e bazuar në ndonjë dokument strategjik apo të politikave.

Faktorët të cilët e pengojnë zhvillimin e OShC-ve vijnë nga të dyja anët. Pikësëpari dhe më e rëndësishmja, apatia e shprehur qytetare nuk krijon presionin e nevojshëm ndaj institucioneve publike për investimin e energjisë dhe fondeve të tyre në një ambient të favorshëm për shoqërinë civile. Distanca në mes të një pjesë të madhe të sektorit të shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi vetëm se i kontribuon kësaj apatie dhe mungese të presionit publik. OShC-të, kryesisht ato të mëdha dhe profesionale, mbeten ndër të paktat të cilat krijojnë kërkesën vendore për ambient të favorshëm, derisa BE-ja është aktori kryesor i jashtëm i cili i shtyn institucionet publike të Kosovës që të punojnë në këtë drejtim. Sektorët e tjerë, siç është sektori i biznesit, mbeten anash përpjekjeve për të krijuar një ambient të favorshëm për zhvillimin e OShC-ve. Edhe një faktor tjetër pengues është niveli i ulët i të kuptuarit të konceptit të shoqërisë civile dhe i potencialit të saj për ndërtimin e një shteti demokratik dhe funksional, duke përfshirë mungesën e kapaciteteve konkrete për t'i kontribuar ambientit të favorshëm. Problemet me sundimin e ligjit dhe korrupsionin, si dhe zhvillimet politike shumë dinamike janë një barrë shtesë në mbajtjen e zhvillimit të shoqërisë civile në listën e prioriteteve si qeveritare, ashtu edhe të shoqërisë

⁷ Indeksi i Kosovës për shoqëri civile 2013, KCSF 2014.

⁸ Matrica monitoruese për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile – Raporti për Kosovën 2013, KCSF 2013.

civile. Në fund e që gjithashtu është specifike për këtë periudhë raportuese, kriza e thellë politike që ka ardhur si pasojë e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të qershorit të vitit 2014 e ka bllokuar funksionimin normal të shtetit, përfshirë nismat në vijim e sipër për përmirësimin e ambientit për zhvillimin e shoqërisë civile

Derisa mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore e cila qëndron prapa shumë vështirësive në avancimin e ambientit për veprim të OShC-ve, disa prej faktorëve janë gjithashtu rezultat i zhvillimit historik të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në Kosovë. Historia e shoqërisë civile në Kosovë është pjesë e një tregimi më të gjerë në Europën lindore gjatë rënies së komunizmit, por gjithashtu e ndikuar nga rrethanat unike të Kosovës dhe shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë. Pas suspendimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, shoqëria civile u bë pjesë e rezistencës paqësore, duke bashkëpunuar së afërmi me Qeverinë paralele të themeluar për t'iu kundërvënë Beogradit, duke ofruar shërbime shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe të arsimit. Suksesi i Lëvizjes për pajtimin e gjaqeve është vetëm një shembull i popullaritetit dhe fuqisë së shoqërisë civile gjatë kësaj epoke⁹. Thuajse e tërë popullata e Kosovës ishte aktive gjatë një dekade të plotë të solidaritetit shoqëror dhe vullnetarizmit. Pas çlirimit dhe pavarësisë, motivi i lartë politik i asaj kohe nuk ekziston më, ndërsa ka kohë që burimet e energjia e asaj kohe janë shpenzuar¹⁰. Gjatë vitit 2014, kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin e shtetit ka rënë edhe më tutje, ku edhe ka arritur nivelin më të ulët për një kohë të gjatë. Tani, 72% e qytetarëve të Kosovës, duken të jenë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin e tashëm politik të Kosovës, 78.6% e kanë të njëjtin mendim për drejtimin ekonomik, derisa kënaqshmëria me punën e Qeverisë (19.3%) dhe Kuvendit (16.1%) ka arritur nivelet më të ulëta ndonjëherë.¹¹

Shoqëria civile është përballur me ndryshime rrënjësore pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999, dhe përqendrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në ndërtimin e paqes dhe rindërtim. Për më tepër, një mori e donatorëve të huaj i kanë shtyrë OShC-të të luajnë rol të madh por gjithashtu, në disa raste, në mënyrë të fshehtë apo të hapur, kanë definuar parametrat e atij roli. Për pjesën më të madhe të periudhës së qeverisjes ndërkombëtare dhe administrimit të dyfishtë nga UNMIK-u dhe institucionet vendore gjatë viteve të 2000, shoqëria civile kryesisht është përqendruar në veprime emergjente dhe të rindërtimit, si dhe të pajtimit ndëretnik, duke pasur shumë pak angazhime me institucionet publike. Me marrjen e përgjegjësisë nga ana e institucioneve vendore dhe sidomos pas pavarësisë të Kosovës, administrata e re publike dhe mungesa e përvojës në bashkëpunimin me shoqërinë civile vazhdon të paraqet vështirësi shtesë në zhvillimin e legjislacionit dhe mekanizmave të ri, por edhe më shumë në fazën e zbatimit.

4. Karakteristikat dhe sfidat specifike në zbatimin e Matricës në Kosovë

Çfarëdo analize e shoqërisë civile bazuar në të dhëna empirike është një ndërmarrje mjaft sfiduese, për shkak të zbrazëtirave të mëdha në të dhënat në dispozicion nga Agjencia e Statistikave apo nga institucionet e tjera, të cilat janë kompetente për pjesë specifike të zhvillimit të shoqërisë civile. Kjo ka ndodhur gjithashtu edhe në rastin e vlerësimit të gjendjes në lidhje me indikatorët specifik të 13

⁹ UNDP, Raporti për zhvillimin njerëzor 2008, Shoqëria civile dhe zhvillimi, f.12, http://hdr.undp.org/sites/default/files/nhdr_2008_kosovo_al.pdf

¹⁰ KCSF-CIVICUS, Indeksi i shoqërisë civile, Raport analitik për Kosovën 2011, Qeverisje më e mirë për ndikim më të lartë, Thirrje për qytetarët, f.23, <https://civicus.org/downloads/CSI/Kosovo.pdf>

¹¹ UNDP, Pulsi publik, Kosovë VIII (Nëntor 2014), f.3-7. http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/pp8/PP_8_Alb.pdf

standardeve të Matricës, si për vitin 2013 ashtu edhe për 2014. Në vitin 2013, KCSF ka shfrytëzuar një studim gjithëpërfshirës për shoqërinë civile i cili është ndërmarr paralelisht me këtë raport të monitorimit, derisa në vitin 2014 është detyruar të kryej sondazhe shtesë të projektuara specifikisht për këtë Raport. Për më tepër, mungesa e institucioneve funksionale për një periudhë mjaft të gjatë të vitit 2014 ishte një ngarkesë shtesë sa i përket disponueshmërisë së personave kompetent që të japin informata të përditësuara në lidhje me çështje të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë civile. Për ta ilustruar këtë, një numër i proceseve legjislative të iniciuara në fillim të vitit 2014 ishin ndërprerë për shkak të shpërbërjes së Kuvendit dhe për më shumë se gjashtë muaj asnjë zyrtar nuk ka qenë në gjendje ta konfirmoj se a do të vazhdonin ato iniciativa apo jo.

Për raportin e vitit 2013, një sfidë shtesë ishte edhe legjislacioni i fragmentuar i cili përmban dispozita specifike relevante për zhvillimin e shoqërisë civile. Shumica e këtyre dispozitave specifike janë “të fshehura” nëpër një numër të madh të ligjeve dhe udhëzimeve administrative, dhe navigimi nëpër këtë sistem kompleks të legjislacionit, si dhe ndërlidhja e duhur e tyre ka kërkuar punë të jashtëzakonshme të hulumtimit në zyre dhe analizë. Për raportin e vitit 2014, mungesa e një Qeverie dhe Kuvendi funksional ka qenë një element lehtësues në këtë drejtim, pasi që kjo nënkupton se shumë pak elemente të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë civile kanë ndryshuar gjatë këtij viti, kështu që situata mbetet e ngjashme me monitorimin për vitin 2013.

Se fundi, zhvillimi i shoqërisë civile është një temë e cila nuk është pjesë e punës së shumicës së OShC-ve aktive në Kosovë. Kjo rezulton në numër të kufizuar të raporteve apo të dhënave në dispozicion të cilat do të mund të përdoren për këtë raport.

5. Mirënjohje dhe falënderime

Puna e KCSF-së në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për këtë Raport është bazuar në punë ekipore, e që ka përfshirë pjesën më të madhe të stafit të saj dhe është ndërtuar në rezultatet e një numri të projekteve dhe nismave të tjera të saj. Pa përkrahjen e plotë të të gjithë kolegëve nga KCSF, do të ishte e pamundur që ekipi përgjegjës për këtë Raport ta përfundojë këtë detyrë. Për këtë arsye, kontributi i secilit pjesëtar të ekipit të KCSF-së vlerësohet shumë.

Për më tepër, KCSF dëshiron t’u falënderohet të gjitha atyre OShC-ve dhe përfaqësuesve të institucioneve publike, si dhe të tjerëve nga sektorë të tjerë të cilët kanë pranuar të japin mendimet e tyre përmes përgjigjeve në pyetësor dhe intervistave të drejtpërdrejta. Informatat e mbledhura nga një numër i madh i aktorëve të rëndësishëm për punën e shoqërisë civile në Kosovë kanë qenë vendimtare për të mbuluar shtrirjen e plotë e kësaj Matrice.

Në fund, KCSF e vlerëson përkrahjen e dhënë nga Zyra Ekzekutive e BCSDN-së dhe ECNL në zhvillimin dhe zbatimin e këtij projekti monitorues. Përkrahja e tyre ka qenë një ndihmesë e madhe për t’i vendosur të gjitha informatat përbrenda një formati të definuar mirë dhe të krahasueshëm me rajonin, por në të njëjtën kohë që siguron vend të mjaftueshëm për informata specifike për Kosovën.

Metodologjia

1. Përmbledhje e qasjes metodologjike

Matrica e zhvillimit të shoqërisë civile është zhvilluar duke u bazuar në ekspertizën dhe përvojën rajonale, dhe ka për qëllim t'i adresojë si çështjet e përbashkëta relevante të tërë Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, ashtu edhe çështjet specifike të secilit vend. Derisa monitorimi i parë i vitit 2013 ka mbuluar të gjitha standardet e Matricës së zhvillimit të shoqërisë, raporti i monitorimit për vitin 2014 mbulon vetëm 13 standarde të përzgjedhura. Kjo është vendosur nga një grup i ekspertëve në nivelin regional, duke e marrë parasysh se disa prej elementeve të zhvillimit të shoqërisë nuk i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme. Kjo është arsyeja pse raporti vendor për Kosovën për vitin 2014 rekomandohet të lexohet së bashku me Raportin vendor për Kosovën për vitin 2013, sidomos për ato standarde të cilat nuk mbulohen në Raportin e këtij viti.

Fillimisht, KCSF ka monitoruar zhvillimet kryesore në secilin prej standardeve si pjesë e punëve të përditshme gjatë tërë vitit. Kjo ka mundësuar që ekipi hulumtues ta përqendroj hulumtimin kyç vetëm në ato çështje të cilat kanë pasur nevojë për informata dhe analiza shtesë. Gjatë pjesës së dytë të vitit, KCSF ka ndërmarrë një hulumtim intensiv, i cili ka mbledhur të dhëna për standardet dhe indikatorët e përzgjedhur që janë vlerësuar në raportin për vitin 2014. Mbledhja e të dhënave është bërë duke shfrytëzuar dy lloje të mjeteve për mbledhje të të dhënave: ato cilësore dhe sasiore. Njëzet e gjashtë (26) intervista të hollësishme me informatorët kyçë nga institucionet publike dhe shoqëria civile ishin burimi kryesor i informatave, derisa një numër i intervistave të tjera përmes postës elektronike dhe telefonatave janë shfrytëzuar për të mbledhur apo vërtetuar çështjet që janë ngritur gjatë intervistave të hollësishme. Intervistat kanë pasur për qëllim mbledhjen e të dhënave në lidhje me legjislacionin dhe me praktikën e nënfushave të ndryshme. Për më tepër, me qëllim që të hulumtohen më thellësisht informatat shtesë të dhëna nga informatorët kyçë, intervistat janë kryer me një fleksibilitet shtesë sa i përket temave dhe pyetjeve që janë mbuluar. Pyetjet për intervistat e hollësishme gjenden në Shtojcën e këtij raporti. Një hulumtim i organizatave i është shpërndarë 100 OShC-ve aktive ku me sukses të njëjtit i janë përgjigjur 41 OShC aktive gjatë periudhës shtator-nëntor të vitit 2014. Sondazhi është përdorur për të vlerësuar perceptimet e OShC-ve në lidhje me elementet kyçe të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, të cilat më pastaj janë analizuar në lidhje me të gjeturat e hulumtimit në zyrë dhe me intervistat e hollësishme. Përzgjedhja e OShC-ve të cilat e kanë marrë pyetësin e sondazhit është bazuar në një mostër standarde e cila përfaqëson OSHC-të e vogla dhe të konsoliduara, si dhe në përfaqësim të barabartë gjeografik dhe sektoral. Bazuar në pyetësin e Matricës të zhvilluar për tërë regjionin, në këtë pyetësor janë përfshirë pyetje specifike të përshtatura për Kosovë. Pyetjet e pyetësorit gjenden në Shtojcën e këtij Raporti. Së fundi, një hulumtim gjithëpërfshirës në zyrë i legjislacionit relevant në fuqi dhe raporte të organizatave dhe institucioneve të tjera lokale dhe ndërkombëtare ka shërbyer për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kryesisht për monitorimin e indikatorëve për legjislacionin.

Përveç kësaj, duke ndërtuar mbi përvojën e gjerë të KCSF-së në nisma të ndryshme për zhvillimin e shoqërisë civile si dhe iniciimin, dizajnimin dhe zbatimin e pjesëve të shumta të legjislacionit dhe mekanizmave për lirinë e asociimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile, informata dhe përvoja të brendshme janë përdorur për nënfushën 1.1. (Liria e asociimit); nënfushën 3.1. (korniza dhe praktikën për bashkëpunim) dhe nënfushën 3.2. (pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes dhe të hartimit të politikave).

2. Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve

Komuniteti i OSHC-ve ka qenë i përfshirë drejtpërdrejtë në mbledhjen e të dhënave, përmes metodologjive si sasiore ashtu edhe cilësore. Hulumtimi i organizatave është kryer me 41 OShC aktive dhe ka mbuluar një gamë të gjerë të temave të ndërlidhura me ambientin e favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Përveç kësaj, intervistat e hollësishme janë kryer me 26 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Përzgjedhja e të intervistuarve është bazuar në metodën e “informatorëve kyç”, të cilët janë përzgjedhur bazuar në përfshirjen e tyre në fusha të ndryshme të mbuluara nga nënfusha specifike të kësaj matrice, duke supozuar se ata kanë informata dhe të dhëna të cilat mund të eksplorojnë nga intervistuesit. Numri i informatorëve kyç ka pasur për synim të mbuloj secilën prej nënfushave të përzgjedhura për monitorim gjatë vitit 2014. Secili grup i intervistuar ka pasur një numër të pyetjeve standarde, si dhe të pyetjeve specifike, varësisht nga fusha e tyre specifike e ekspertizës apo përvojës. Për t’i plotësuar informatorët kyç, metodologjia ka përfshirë intervistimin e një numri të “personave të jashtëm”, kryesisht të organizatave të cilat nuk janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me nënfushat specifike, por të cilat mund të kenë informata apo mendime për cilindo tregues ose nënfushë të matricës.

3. Mësimet e nxjerra

Për t’i përcjellë zhvillimet në një listë kaq të gjerë të fushave dhe standardeve, është e rëndësishme të mbahen shënime për nismat dhe ndryshimet gjatë tërë vitit, në vend të përqendrimit të tërë hulumtimit brenda një periudhe specifike kohore. Për dy raundet e para të monitorimit në vitet 2013 dhe 2014, ky ka qenë një hulumtim intensiv, i cili është kryer gjatë pjesës së dytë të vitit e i cili ka mbledhur të dhëna për ti kompletuar raportet e monitorimit. Edhe pse KCSF ka një pozitë shumë të mirë përbrenda të gjitha forumeve kryesore të ndërlidhura me zhvillimin e shoqërisë civile, bazuar në dy raundet e para të monitorimit, ajo ka vendosur të krijoj “regjistra tematik” dhe ti përcjellë të gjitha zhvillimet e rëndësishme gjatë tërë periudhës raportuese.

Një mësim tjetër që është nxjerrë është i veçantë për metodologjinë e shfrytëzuar për raportin e monitorimit për vitin 2014. Derisa standardet e përzgjedhura për monitorim për këtë vit i kanë mbuluar standardet më të rëndësishme përbrenda zhvillimit të shoqërisë civile, ka pasur edhe informata të tjera të rëndësishme të cilat është dashur të përfshihen në raport, informata këto të cilat bien jashtë standardeve të përzgjedhura. Për shembull, gjatë monitorimit të standardeve 2 dhe 3 përbrenda nënfushës 1.1 (Liria e asociimit), ka qenë e vështirë të shmanget analiza dhe përfshirja në raport e pjesëve të caktuara të Standardit 1 të kësaj nënfushë, e të cilat japin kontekstin për Standardet 2 dhe 3. Sidoqoftë, zgjidhja është gjetur duke përfshirë vetëm ato pjesë të standardeve të papërzgjedhura të domosdoshme, e jo të mbulohet e tërë lista e indikatorëve.

Të gjeturat dhe rekomandimet

Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive

Nënfusha 1.1.: Liria e asociimit

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 1.1.2: OShC-të punojnë lirshëm, pa ndërhyrjen e paarsyeshme të shtetit në drejtimin e dhe aktivitetet e tyre të brendshme dhe Standardi 1.1.3: OShC-të lirshëm mund të kërkojnë dhe sigurojnë burime financiare për ta përkrahur veprimtarinë e tyre nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja. Për ta kuptuar kontekstin e standardeve të përzgjedhura, kjo nënfushë gjithashtu përmban një përshkrim shumë të shkurtër të Standardit 1.1.1: Të gjithë individët dhe subjektet juridike mundën lirshëm të themelojnë dhe marrin pjesë nëpër organizata joformale dhe/apo të regjistruara, qofshin këto on-line apo jo.

Korniza ligjore për lirinë e asociimit nuk është ndryshuar gjatë vitit 2014, dhe liria e asociimit vazhdon të jetë e drejtë kushtetuese, e garantuar përmes nenit 44 të Kushtetutës së Kosovës dhe e përcaktuar në Ligjin 04/L-57 për lirinë e asociimit në OJQ. Në muajin prill të vitit 2014, Departamenti për OJQ ka iniciuar një Koncept-Dokument për harmonizimin e Ligjit për lirinë e asociimit në OJQ me Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mirëpo, kjo nismë nuk ka rezultuar me ndonjë Koncept-Dokument zyrtar për procesin e plotësim-ndryshimit të ligjit.

Gjatë vitit 2014, një udhëzim administrativ që rrjedh nga Ligji për lirinë e asociimit në OJQ është miratuar nga Qeveria, përmes të cilit caktohen rregullat për regjistrimin dhe punën e OJQ-ve. Derisa procesi i hartimit ka qenë gjithëpërfshirës dhe OShC-të dhanë kontribut mjaft të madh, një nen për suspendimin e OJQ-ve është futur në këtë udhëzim pas përmbjlljes zyrtare të procesit të hartimit. OShC-të, përfshirë këtu ato të angazhuara drejtpërdrejt në procesin e hartimit, morën vesh për këtë vetëm pas miratimit

Neni 18 i Udhëzimit administrativ QRK–Nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve i shtatorit të vitit 2014, lejon që Departamenti i OJQ-ve ta pezulloj një OJQ për periudhë maksimale kohore prej një viti, bazuar në çfarëdo kërkesë nga institucione e autorizuara të sigurisë. Katërmëdhjetë (14) OJQ janë pezulluar menjëherë pas miratimit të kësaj Rregulloreje, me arsyetimin se aktivitetet e tyre bien ndesh me rregullimin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare.

dhe publikimit të tij. Konkretisht, neni 18 i Udhëzimit administrativ QRK – nr.: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve¹² i lejon Departamentit të OJQ-ve ta pezullojë veprimtarinë e një OJQ-je, me kërkesën me shkrim dhe arsyetimin e një institucioni të autorizuar të sigurisë. Kohëzgjatja

maksimale për pezullim është një vit, dhe arsyetimi mund të jetë i bazuar në ato raste ku pretendohet se aktivitetet e OJQ-së nuk përkojnë me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare. Ky nen lejon ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit në qeverisjen e brendshme dhe aktivitetet e OJQ-ve. Në praktikë, kjo ndërhyrje është raportuar menjëherë pas miratimit të Udhëzimit administrativ QRK – Nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve. Bazuar në këtë, 14 OJQ janë pezulluar në shtator të vitit 2014.

¹² <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10287>

Kërkesat për raportim financiar nuk kanë ndryshuar gjatë vitit 2014. Kërkesat për raportim janë të dy niveleve: raportimi të Administrata Tatimore për transaksionet e tyre financiare dhe raportimi Departamenti për OJQ për organizata me status të përfitimit publik (SPP). Kërkesat e raportimit të Administrata Tatimore janë të ngjashme me bizneset dhe shumica e OShC-ve të intervistuar konsiderojnë se këto kërkesa nuk janë në përputhje me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Në anën tjetër, raportimi i SPP-vë është si për pjesën programore ashtu edhe për atë financiare, dhe organizatat me SPP të cilat kanë të ardhura mbi 100,000 EUR duhen gjithashtu të dorëzojnë një raport të auditimit të jashtëm. Formularë të rinj të raportimit programor janë hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2014.

Nenet restriktive të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹³ (dhe ndryshimet e tij)¹⁴ ende janë të zbatueshme dhe është raportuar se janë të rënda për OJQ-të. OJQ-të janë i vetmi sektor të cilit i nevojitet autorizimi paraprak për të pranuar fonde mbi 1,000 EUR nga një dërgues i vetëm apo për të paguar më shumë se 5,000 EUR për një pranues të vetëm, brenda një dite. Që të jenë në gjendje të kryejnë apo pranojnë pagesa të cilat i tejkalojnë shumat e specifikuar më lartë, OJQ-ja mund të kërkojë nga Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NjIF-K) përjashtim nga këto obligime për një herë apo për një periudhë të caktuar kohore. Kërkesat me shkrim që i dorëzohen NjIF-K-ut nga OJQ-ja duhen të theksojnë llojin e përjashtimit dhe arsyet për këtë përjashtim, derisa NjIF-K-ut duhet t'i përgjigjet kësaj kërkesë brenda tridhjetë (30) ditëve. Përgjigjet e NjIF-K-ut mund të jenë: 1) lejohet 2) lejohet me kusht ose 3) refuzohet. Mirëpo i tërë procesi i kërkesës dhe përgjigjes nuk përmban kritere të cilat do të duhej të merren parasysh nga NjIF-K gjatë marrjes së vendimit. Kjo krijon një bazë për interpretime të ndryshme apo vendime arbitrare. Këto kërkesa janë të rënda për OShC-të pasi që ato mund të krijojnë probleme për pranimin e fondeve nga donatorët apo për pagesën e fondeve nga organizatat vendore që shpërndajnë grante.¹⁵ Për më tepër, sanksionet për shkeljen e këtyre kufizimeve janë problematike në dy aspekte: së pari, ato nuk janë në proporcion me shkallën e shkeljes, pasi që ato lejojnë edhe shuarjen e OJQ-ve; së dyti, ato i japin Departamentit për OJQ autoritetin që ta shuaj OJQ-në, e që nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit për lirinë e asociimit në OJQ. Zbatimi i këtij ligji është i kufizuar dhe shumica e OShC-ve nuk janë në dijeni për këto obligime. Njësia e Inteligjencës Financiare ka iniciuar një Koncept-Dokument për ti paraprirë procesit të amandamentimit të këtij Ligji. Konsultimet publike fillestare janë mbajtur në fund të vitit 2014 dhe shoqëria civile ka kërkuar largimin e të gjitha obligimeve specifike për OJQ-të.

Dispozitat ligjore për shuarjen e OJQ-ve përbrenda Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ nuk janë ndryshuar. Mirëpo, Udhëzimi Administrative QRK – nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve ka prezantuar baza të reja për pezullimin e një OJQ-je nga Departamenti i OJQ-ve. Derisa pezullimi i një OJQ-je nuk është kategori ligjore e Ligjit për OJQ, Udhëzimi administrativ i mundëson një organi administrativ që të vendos në lidhje me këtë çështje. Pjesa e shpërndarjes së aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara gjithashtu nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimesh. Përkundër ekzistencës së një Udhëzimi administrativ për themelimin e një Komisioni për shpërndarjen e aseteve të OJQ-vë të shuara, procedurat dhe kriteret specifike për vendimet e këtij Komisioni nuk ekzistojnë.


Në Kosovë, OShC-të lirshëm mund të kërkojnë dhe sigurojnë burime financiare për veprimtarinë e tyre

¹³ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2715>

¹⁴ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8652>

¹⁵ Matrica e monitorimit për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë – Raporti vendor për Kosovën 2013, KCSF 2013.

nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja. Sidoqoftë, kërkesat për autorizim paraprak për të pranuar fonde në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit vazhdojnë të jenë procedura të rënda në kërkimin dhe sigurimin e burimeve financiare. Ligji për lirinë e asociimit në OJQ që i lejon OShC-të të merren me aktivitete të ndryshme ekonomike nuk ka ndryshuar, derisa aktivitetet e ndërlidhura ekonomike gjithashtu janë të liruara nga tatimi në fitim, bazuar në Ligjin për tatimin në të ardhura të korporatave¹⁶. Mirëpo, 83% të OShC-ve të anketuara deklarojnë se nuk merren me aktivitete ekonomike dhe shumë prej tyre nuk janë të njoftuar me obligimet dhe kufizimet e ndërlidhura.



Administrata Tatimore e Kosovës gjithashtu nuk i ka përmirësuar kapacitetet e saj në lidhje me trajtimin e natyrës specifike të punës së OShC-ve, dhe në shumicën e rasteve OShC-të vazhdojnë të trajtohen ngjashëm me biznese. Pranimi i fondeve të huaja është i lejuar – përderisa nuk ka të dhëna për vitin 2014, në vitin 2013 74% të burimeve të shoqërisë civile kanë ardhur nga

donatorët ndërkombëtarë.¹⁷ Përveç kësaj, OShC-të mund të pranojnë fonde edhe nga individët, korporatat apo edhe nga burime të tjera, por në praktikë filantropia individuale dhe korporatave nuk ndodh shpesh. 82.9% të OShC-ve të anketuara kanë deklaruar se nuk pranojnë fonde nga kompanitë private apo individët. OShC-të vazhdojnë mos të jenë të liruara nga TVSH-ja, derisa në praktikë përjashtimet janë të ndërlidhura me burimin e fondeve – fondet që vijnë nga BE apo nga shumica e donatorëve bilateral janë të liruara nga TVSh-ja, pavarësisht se cili operator ekonomik operon me këto fonde. Si rezultat i kësaj, OShC-të të cilat përfitojnë nga këto fonde gjithashtu i nënshtrohen këtij lirimi, vetëm për atë pjesë të fondeve. Mirëpo, procedura e lirimit nuk është e njësuar për të gjithë donatorët dhe lirimi praktik krijon vështirësi për OShC-të në shumë raste. Për më tepër, periudha e lirimit nga tatimi për fonde të huaja ka mbaruar me 31 dhjetor të vitit 2014 dhe Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka vazhduar këtë lirimi.

Për të përmbledhur, kurrfarë ndryshime të rëndësishme nuk janë bërë në vitin 2014, me përjashtim të Udhëzimit administrativ QRK – nr.:02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, i cili ka futur bazën për ndërhyrjen shtetërore në çështjet e brendshme të OShC-ve. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e legjislacionit për themelimin dhe funksionimin e OShC-ve vazhdon të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, mirëpo zbatimi i duhur i tij pengohet nga kapacitetet e kufizuara të institucioneve publike dhe mungesa e harmonizimit me ligje/mekanizma të tjerë relevantë për veprimtarinë e OShC-ve.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 1.1 janë:

- **Departamenti i OJQ-ve duhet të bashkëpunojë me të gjithë akterët relevantë për ta analizuar Ligjin për lirinë e asociimit dhe zbatimin e tij, me synim të identifikimit të zbrazëtirave ligjore dhe sfidave në zbatim, dhe bazuar në rezultatet e kësaj analize duhet nisur një proces për**

¹⁶ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2659>

¹⁷ Indeksi i shoqërisë civile të Kosovës 2013, KCSF 2014.

amandamentimin e tij;

- Pavarësisht analizës së lartpërmendur, neni 18 i Rregullores për regjistrimin e OJQ-ve, përmes të cilit Departamenti i OJQ-ve mund të bëjë pezullimin e OJQ-ve, duhet të hiqet menjëherë;
- Kapacitetet e Departamentit të OJQ-ve duhen të ngritën në mënyrë që të interpretohet dhe zbatohet si duhet Ligji për lirinë e asociimit në OJQ;
- Korniza ligjore për raportimin financiar të OShC-ve duhet ta prezantojë një sistem, ku merret parasysh natyra specifike e OShC-ve;
- Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit duhet të amendamentohet që të hiqen të gjitha nenet restriktive për OJQ-të, përfshirë kërkesat për autorizim paraprak në lidhje me pranimin dhe shpërndarjen e fondeve, së bashku me veprat penale për mospërbushje të këtyre obligimeve.

“Udhëzuesi i BE-së për përkrahjen e shoqërisë civile në shtetet e zgjerimit 2014-2020”¹⁸ është një dokument i cili cakton kornizën strategjike të përkrahjes së BE-së për sektorin e shoqërisë civile për shtetet e zgjerimit dhe përqendrohet në ambientin e favorshëm dhe kapacitetet e OShC-ve. Pjesa për ambientin e favorshëm është e bazuar kryesisht në Matricën e monitorimit, ndërsa raportet e secilit vend do të shërbejnë për vlerësimin e indikatorëve specifikë të Udhëzuesit të BE-së. Në secilën prej nënfushave të vlerësuara, do të jepet vlerësimi i përgjithshëm për indikatorët përkatës të Udhëzuesit të BE-së, bazuar në monitorimin e nënfushave përkatëse të Matricës së monitorimit.

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së

Vlerësimi i Matricës së monitorimit

1.1.c. Vlerësimi cilësor i kornizave të politikave dhe atyre ligjore

1.1.d. Përparimi në miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant

2.1.a. Perceptimi i OShC-ve për lehtësinë dhe efektshmërinë e rregullave financiare dhe kërkesave të raportimit (të ndara sipas llojit / madhësisë së OShC-ve)

2.1.b. Vlerësimi i cilësisë së rregullave financiare

Korniza ekzistuese e politikave dhe ligjore për ushtrimin e të drejtës për asociim kryesisht është në vend, derisa zbatimi i saj është i pjesshëm, kryesisht i atyre dispozitave të ndërlidhura me funksionimin e OJQ-ve. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit përmban dispozita restriktive për OJQ-të. Një legjislacion dytësor i miratuar gjatë vitit 2014 ka prezantuar dispozita të cilat lejojnë një organ administrativ të pezullojë OJQ-në, edhe pse pezullimi i OJQ-ve nuk ka bazë ligjore në legjislacionin primar. Gjatë vitit 2014 nuk është vërejtur ndonjë përmirësim në zbatim të legjislacionit.

Rregullat financiare dhe kërkesat e raportimit për OShC-të janë të ngjashme me ato të bizneseve dhe shumica e OShC-ve konsiderojnë se ato nuk janë të përshtatshme me natyrën specifike të punës së

¹⁸ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/civil_society/doc_guidelines_cs_support.pdf

(me përqendrim në mekanizmat e ndërthurur të cilat mundësojnë ndryshimin e rregullave dhe obligimeve financiare varësisht nga ndryshimi i qarkullimit dhe aktiviteteve jokomerciale).

tyre. Kapacitetet e Administratës Tatimore për të trajtuar specifikat e OShC-ve janë të kufizuara. Nuk është vërejtur ndonjë përmirësim në kornizën ligjore dhe kapacitetet zbatuese gjatë vitit 2014.


Nënfusha 1.2.: Liritë e ndërlidhura

Kjo nënfushë është e bazuar në standardin e përzgjedhur në vijim: Standardi 1.2.1: Përfaqësuesit e OShC-ve, qoftë individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e tubimit paqësor.

Korniza ligjore për të drejtën e tubimit në Kosovë nuk i është nënshtruar ndonjë ndryshimi gjatë vitit 2014. Përfaqësuesit e OShC-ve kosovare, individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë të drejtën e tubimit të qetë. Kjo është e drejtë kushtetuese, sipas nenit 43 të

Në shkurt të vitit 2014 është lajmëruar një rast i intervenimit të policisë. Policia ka intervenuar gjatë protestave të organizuara nga shoqatat studentore dhe të përkrahura nga OShC-të e tjera, ku është kërkuar dorëheqja e rektorit të Universitetit të Prishtinës. Në mes të 33 protestuesve të arrestuar ka pasur gjithashtu edhe aktivistë të shoqërisë civile, përfshirë drejtorin e një OShC-je mjaft të njohur.

Kushtetutës, derisa Ligji 03/L-118 për tubimet publike¹⁹ i garanton çdo qytetari të Kosovës të drejtën për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime publike. Nuk ekzistojnë dispozita në lidhje me të drejtën e tubimit për ata të cilët nuk janë qytetarë të Kosovës. Korniza ligjore kërkon njoftim paraprak për tubime publike, përveç në ato vende ku nuk ka nevojë për masa shtesë të sigurimit. Kur nuk jepet përgjigja nga autoritetet në kohën e duhur (48 para tubimit publik)²⁰, tubimi publik mund të mbahet pa kurrfarë kufizimi. Për çfarëdo kufizimi pas njoftimit të dhënë për tubimin publik, mund të ushtrohet ankesa në



Gjykatë nga organizatorët e tubimit përmes procedurës së shpejtë. Kundërtubimet nuk janë të ndaluara specifikisht, edhe pse dispozitat lënë të kuptohet se nëse një protestë tjetër është paralajmëruar në lokacionin e njëjtë apo diku afër, kjo mund të shërbejë si arsye për refuzimin e lejes për organizimin e protestës/tubimit publik. Edhe pse vetëm disa OShC janë deklaruar të kenë qenë të përfshirë në organizimin e protestave paqësore gjatë vitit 2014 (24.4%), ato nuk raportojnë kurrfarë

kufizimi të drejtës së tyre për tu tubuar. Mirëpo, shumë aktivistë të shoqërisë civile ndajnë perceptimin se nëpunësit civilë në mënyrë indirekte janë të kufizuar t'u bashkëngjiten protestave të organizuara nga OShC-të, sidomos atyre për arsye politike²¹. Tubimet, e sidomos protestat e qeta, zakonisht organizohet

¹⁹ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2633>

²⁰ Po aty, neni 6 (3).

²¹ Matrica e monitorimit për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë – Raporti vendor për Kosovën 2013, KCSF 2013.

nëpër sheshe publike apo përpara ndonjë institucioni të veçantë i cili është në shënjestër të protestës, dhe mediet kanë qasje të plotë në këto tubime. Në protestat e organizuara nga OShC-të në vitin 2014, ka pasur vetëm një rast ku është raportuar përdorimi i forcës nga ana e policisë.

Për të përmbledhur, liria e tubimit është e garantuar me ligj, dhe OShC-të në përgjithësi e ushtrojnë këtë të drejtë lirshëm, përkundër rasteve të izoluara të intervenimit të policisë gjatë protestave.

Rekomandimet kyçe për nënfushën 1.2 janë:

- **E drejta për tubim për qytetarët që nuk janë banorë të Kosovës duhet të rregullohet, ku në mënyrë eksplicite duhet të garantohet e drejta e tyre për tubim**

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
<p>1.1.c. Vlerësimi i cilësisë së kornizës ekzistuese legjislative dhe të politikave</p> <p>1.1.d. Përparimi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant</p>	<p>Korniza ekzistuese e politikave dhe ligjore për ushtrimin e të drejtës për tubim kryesisht është në vend. Njoftimi paraprak për tubime publike është i domosdoshëm dhe procedura e ankesës në rast të refuzimit bëhet përmes procedurës së shpejtë. OShC-të ushtrojnë këtë të drejtë lirshëm, edhe pse vetëm disa OShC kanë deklaruar të kenë qenë të përfshirë në ushtrimin e të drejtës për protestë të qetë. Vetëm një rast i intervenimit të policisë në protestat e organizuara nga shoqëria civile është raportuar gjatë vitit 2014. Korniza ligjore për të drejtën e tubimit nuk i është nënshtruar ndonjë ndryshimi gjatë vitit 2014.</p>

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

Kjo nënfushë është vlerësuar në bazë të standardit të përzgjedhur në vijim: Standardi 2.1.1: Lehtësirat tatimore janë në dispozicion për burime të ndryshme të të hyrave për OShC-të.

Nuk ka pasur ndryshime në kornizën ligjore për trajtimin tatimor të OShC-ve dhe donatorëve të tyre gjatë vitit 2014, edhe pse një proces i amanadamentimit për pakon e ligjeve tatimore dhe fiskale është paralajmëruar për vitin 2015. Në Kosovë, korniza ligjore mundëson lehtësime tatimore për një numër të burimeve të të ardhurave të OShC-ve, edhe pse efekti i tyre në praktikë është i kufizuar. Grantet dhe donacionet që përkrahin aktivitetet jofitimprurëse të OShC-ve lirohen nga tatimi dhe nuk ka raportime se burime të tilla të të ardhurave janë tatuar ndonjëherë. Sa i përket aktivitetit ekonomik, kornizën ligjore është e paqartë, sidomos për aktivitetet ekonomike të OJQ-ve të cilat nuk e kanë Statusin për Përfitim Publik. Nga dispozitat për lehtësime tatimore për aktivitete ekonomike nuk është e qartë se a i përfshijnë këto të gjitha OJQ-të apo vetëm ato që e kanë SPP-në. “Çfarëdo organizate joqeveritare e cila kryen çfarëdo aktiviteti komercial apo tjetër i cili nuk është ekskluzivisht i ndërlidhur me qëllimin e saj publik do të ngarkohet me tatim në të ardhura ...”²², derisa aktivitetet e ndërlidhura ekonomike të OShC-ve janë të liruara nga tatimi deri në “një nivel të arsyeshëm të të ardhurave”²³. Interpretimet nga inspektorët tatimorë të dhëna gjatë trajnimeve të organizuara nga KCSF thonë se vetëm aktivitetet ekonomike të organizatave me SPP lirohen nga tatimi në të ardhura, derisa të gjitha aktivitetet e tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit në të ardhura. Për më tepër, nivel i arsyeshëm i të ardhurave janë të ardhurat të cilat sigurojnë qëndrueshmëri dhe zhvillim të OShC-së. Mirëpo, derisa Ligji 03/L- 162 për tatimin në të ardhura të korporatave mund të interpretohet në atë mënyrë që të gjitha organizatat joqeveritare i nënshtrohen lehtësimeve tatimore të lidhura me aktivitetet ekonomike, Udhëzimi përkatës administrativ 14/2010, ku shpjegohet zbatimin e tij flet vetëm për organizatat me Status për Përfitim Publik. Kjo mungesë e koherencës shkakton vështirësi në interpretim dhe zbatim, dhe shumë OShC zgjedhin të mos përfshihen fare në aktivitete ekonomike.²⁴ Kjo konfirmohet gjithashtu edhe nga rezultatet e sondazhit të vitit 2014 ku vetëm 17.1% të OShC-ve deklarojnë të jenë përfshirë në aktivitete ekonomike. Përkundër bllokadës politike gjatë vitit 2014, Administrata Tatimore ka raportuar se grupet e brendshme punuese janë themeluar për t’i identifikuar çështjet të cilat duhen të amandamentohen në ligjet tatimore dhe fiskale, përderisa një proces formal mund të iniciohet gjatë vitit 2015. OShC-të ende nuk janë ftuar të kontribuojnë në këtë proces.

Me përjashtim të atyre që u përmendën më lart, donacionet nga korporatat dhe nga një kategori e individëve për qëllime humanitare, arsimore, fetare, shkencore, të mbrojtjes së mjedisit apo sportive të dhuruara tek organizatat me status të përfituesit publik llogariten si shpenzime dhe janë të liruara deri në 5% të të ardhurave të tatueshme të tyre. Mirëpo, të dhënat nga sondazhi i vitit 2013 tregojnë se shumë

²² Ligji 03/L- 162 për tatim në të hyrat e korporatave – neni 33.

²³ Udhëzimi administrativ nr. 14/2010 për zbatimin e Ligjit nr. 03/L0162 për tatim në të hyrat e korporatave – neni 21.

²⁴ Matrica e monitorimit për mjedisin mundësues të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë – Raporti vendor për Kosovën 2013, KCSF 2013.

pak OShC pranojnë donacione individuale apo të korporatave, dhe shumë rrallë ndonjë prej tyre ka raportuar zbritjet tatimore si arsye kryesore për pranimin e këtyre donacioneve²⁵.

Ngjashëm me këtë, nuk është vërejtur ndonjë ndryshim në lidhje me investimet pasive të OShC-ve apo fondet investive/të dhurimeve. Ende nuk ka dispozita të qarta dhe të hollësishme në lidhje me lehtësirat tatimore për investime pasive të OShC-ve, derisa investimet pasive nuk janë të zakonshme në shoqërinë civile të Kosovës. Nuk ka dispozita në lidhje me themelimin dhe funksionimin e fondeve investive/të dhurimeve, e as të ndërlidhura me lehtësirat tatimore për këto të fundit. Në mes të OShC-ve të intervistuar dhe atyre që i janë nënshtruar sondazhit në vitin 2014, nuk është gjetur asnjë rast i fondeve investive/të dhurimeve të themeluara dhe që operojnë në Kosovë.

Një draft i Ligjit për sponsorim dhe filantropi në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve është në proces të hartimit dhe qarkullimit në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave që disa vite. Gjatë takimit në dhjetor të vitit 2014, Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile ka rekomanduar që fushëveprimi i këtij draftligji duhet të zgjerohet përtej kulturës, rinisë dhe sportit, për t'i përfshirë të gjitha fushat ku mund të zbatohet filantropia dhe sponsorizimi.

Për të përmbledhur, mund të thuhet se lehtësirat tatimore janë në dispozicion për një numër të burimeve të të hyrave të OShC-ve. Grantet dhe donacionet nuk i nënshtrohen tatimit, derisa aktivitetet ekonomike që janë të ndërlidhura me misionin e organizatave me status për përfitim publik janë të liruara nga tatimet. Stimulimet për donatorë privatë janë pjesë e kornizës ligjore, por ato nuk janë motivimi kryesor për donacione private.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 2.1 janë:

- **Ligjet për tatimet, sidomos dispozitat për aktivitetet ekonomike të OShC-ve, duhen të qartësohen dhe harmonizohen plotësisht**
- **Sistemi për zbritje tatimore për individë dhe korporata duhet të reformohet në lidhje me shkallën dhe gamën e zbritjeve dhe mekanizmave zbatues, si dhe të harmonizohet me kapitullin për Statusin e Përfitimit Publik të Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ**
- **Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike duhen të inicojnë politikat dhe kornizën ligjore të cilat specifikisht adresojnë themelimin dhe funksionimin e fondeve investive/të dhurimeve, si dhe investimet pasive të OShC-ve**
- **Draft ligji për donacione dhe filantropi duhet të zgjerohet sa i përket fushëveprimit të tij, përtej kulturës, rinisë dhe sportit**

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
2.3.b. Cilësia e sistemit të lehtësirave tatimore për veprimtarinë dhe aktivitetet ekonomike të OShC-ve	Sistemi i lehtësirave tatimore për veprimtarinë dhe aktivitetet ekonomike të OShC-ve siguron lirim nga tatimi për grante dhe donacione. Vetëm aktivitetet e ndërlidhura me misionin të

²⁵ Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development - Kosovo Country Report 2013, KCSF 2013


organizatave me status për përfitim publik janë të liruara nga tatimi në të ardhura. Sidoqoftë, korniza ligjore në këtë fushë është e paqartë dhe me dykuptimësi. Korniza ligjore për lehtësimet tatimore për aktivitetet e OShC-ve nuk i është nënshtruar ndryshimeve gjatë vitit 2014.

Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 2.2.1: Financimi publik është në dispozicion për zhvillimin institucional të OShC-ve, për përkrahje të projekteve dhe për bashkëfinancimin e granteve të BE-së dhe të granteve të tjera; dhe Standardi 2.2.2: Financimi publik shpërndahet në mënyrë të paraparë dhe transparente.

Gjatë vitit 2014, zyrtarë të lartë të Qeverisë kanë dhënë një numër të premtimeve në lidhje me rregullimin e përkrahjes shtetërore për shoqërinë civile, sidomos gjatë periudhës parazgjedhore. Në një konferencë të organizuar nga projekti TACSO në qershor të vitit 2014, Ministri i Financave ka deklaruar se rregullimi i fondeve shtetërore për shoqërinë civile është një prej fushave prioritare të ministrisë së tyre. Megjithatë, këto nuk kanë rezultuar me hapa konkret në rregullimin e kësaj fushe dhe nuk është vërejtur ndonjë ndryshim gjatë vitit 2014.


Sidoqoftë, nuk ka financim publik për zhvillimin institucional të OShC-ve dhe bashkëfinancim të granteve të BE-së dhe granteve të tjera, derisa përkrahja për projekte është e pranishme në disa raste, kryesisht në nivelin lokal. Përkrahja shtetërore për OShC-të nuk rregullohet nga asnjë ligj i veçantë apo politikë shtetërore, e ngjashëm nuk ekziston asnjë mekanizëm kombëtar apo lokal për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC-të. Gjatë vitit 2013, KCSF ka identifikuar një ngritje të pjesëmarrjes së fondeve publike në fondet e përgjithshme për shoqërinë civile²⁶, derisa në vitin 2014, 24.4% e OShC-ve të intervistuar kanë raportuar se kanë pranuar fonde publike. Këto fonde u shpërndahen OShC-ve nga institucione specifike të nivelit qendror dhe lokal, pa kurrfarë bashkëpunimi apo ndërlihdje. Këto fonde nuk janë të planifikuara përbrenda buxhetit shtetëror, ndërsa në Buxhetin e Kosovës mund të identifikohen shumë pak raste të linjave specifike buxhetore për OShC-të. Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile ka përfshirë identifikimin e modelit për financim publik të OShC-ve si një prej prioriteteve për vitin 2015, dhe ky ka qenë i vetmi zhvillim pozitiv për periudhën raportuese.



²⁶ Indeksi për shoqërinë civile të Kosovës 2013, KCSF 2014.

Ligji 04/L- 080 për lojërat e fatit²⁷ siguron mundësinë e drejtimit të një pjese të fondeve nga Llotaria e Kosovës të kategoritë e ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport. Detajet e transferimeve të tilla do të duhej të përcaktohen përmes një udhëzimi administrativ, mirëpo një udhëzim i tillë nuk është hartuar ende dhe nuk ka raporte se fonde të tilla janë mbledhur apo shpërndarë. Zyrtarët e intervistuar nga Ministria e Financave nuk ishin në gjendje të na siguronin të dhëna për shumën e fondeve të shpërndara të OShC-të për vitin 2014, përfshirë këtu çfarëdo detajesh për fonde të bazuara në lojërat e fatit. Kjo konfirmon se financimi është i paparashikueshëm dhe se është e pamundur të identifikohen shumën e fondeve publike të zotuar apo të shpërndara tek OShC-të. Pasi që buxheti pjesëmarrës nuk është i zakonshëm në Kosovë, OShC-të nuk janë pjesë e programit të financimit publik as edhe për fondet publike të shoqërisë civile.

Gjithashtu, nuk është bërë kurrfarë ndryshimi në procedurat për shpërndarjen e fondeve publike. Nuk ka procedura specifike për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC-të, e gjithashtu mungojnë kriteret standarde të përzgjedhjes të cilat do të siguronin që financimi publik do të bëhej në një mënyrë të përcaktuar paraprakisht. Për shkak të mungesës së planifikimit specifik të buxhetit dhe të informatave për përzgjedhjen, është shumë vështirë të mblidhen të dhënat e duhura në lidhje me shumën, llojet e projekteve dhe organizatat të cilat përfitojnë nga fondet publike. Ka shumë pak informata në dispozicion të publikut për kërkesat e aplikimit dhe shumica e vendimeve për tenderët nuk janë transparente. Kështu, 61% e OShC-ve



të anketuara kanë deklaruar se përfituesit e fondeve, emrat e përfituesve dhe shumën e projekteve nuk janë publikuar dhe vetëm 4.8% prej tyre deklarojnë se informatat janë publikuar në mënyrë të hollësishme. Të vetmet procedura specifike për OShC-të për adresimin e konfliktit të interesit në lidhje me financimin shtetëror janë të lidhura me OShC-të që kanë zyrtarë publik si anëtarë të bordit, edhe pse nuk ka informata në dispozicion në lidhje me drejtësinë e vendimeve apo konfliktin e interesit.

Situata është e njëjtë edhe sa i përket llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimit publik të OShC-ve, dhe nuk është arritur kurrfarë përmirësimi gjatë vitit 2014.

Për të përmbledhur, qasja e institucioneve publike nuk kontribuon në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të OShC-ve. Zotimet politike për ta rregulluar përkrahjen shtetërore për shoqërinë civile nuk kanë rezultuar në ndonjë përparim konkret në këtë fushë. Edhe pse pjesa e fondeve publike për OShC-të është duke u rritur, nuk ekzistojnë kriteret, standarde e as procedura për programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 2.2 janë:

- Një sistem gjithëpërfshirës për financimin publik duhet të iniciohet, bazuar në objektivat e

²⁷ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2813>

Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile; dhe kriteret, standardet dhe procedurat e dizajnuara duhet të sigurojnë zbatim transparent dhe llogaridhënës të fondeve publike për OShC-të. Pavarësisht sistemit gjithëpërfshirës, të gjitha informatat për fondet publike të shpërndara tek OShC-të duhen të bëhen transparente menjëherë.


- OShC-të duhet të jenë pjesë e hartimit të sistemit gjithëpërfshirës për financimin publik dhe zbatimin e tij, në linjë me standardet e Matricës së Monitorimit.

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
<p>2.4.a. Proporcioni i shumës së kërkuar me shumën e miratuar/shpërndarë për vit përmes financimit shtetëror për OShC-të. (kjo dëshmon disponueshmërinë e fondeve)</p> <p>2.4.b. Cilësia e kornizave të financimit shtetëror për organizata të shoqërisë civile (me përqendrim në dokumentet procedurale)</p>	<p>Nuk ekziston ndonjë kornizë për financim shtetëror të OShC-ve në Kosovë, edhe pse institucionet shtetërore gjithnjë e më shumë ndajnë fonde për OShC-të. Për shkak të mosekzistencës së planifikimit buxhetor, mekanizmave specifik për shpërndarje dhe standardeve për monitorim dhe vlerësim, nuk ka të dhëna në dispozicion në lidhje me shumën e kërkuara dhe të shpërndara. Përkundër zotimeve nga zyrtarë të lartë gjatë vitit 2014, ende nuk është vërejtur ndonjë përparim në këtë fushë.</p>

Nënfusha 2.3.: Burimet njerëzore

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 2.3.1: OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë; dhe Standardi 2.3.2: Ekzistojnë politika dhe ligje përkrahëse për vullnetarizëm.

Përkundër kërkesave të shumta për ta ndryshuar Ligjin e punës²⁸, për shkak të krizës politike të vitit 2014, nuk është filluar ndonjë proces formal për amendamentimin e tij. Kur OShC-të punësojnë persona, nuk ka kërkesa apo regjistrime shtesë në raport me kompanitë komerciale, dhe sipas ligjit OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë. Megjithatë, OShC-të nuk trajtohen në kuadër të programeve shtetërore të nxitjes së punësimit, dhe në përgjithësi, sektori i shoqërisë



civile nuk trajtohet si një prej sektorëve që kontribuon në punësim. Derisa ka programe të caktuara për gjenerimin e punësimit në sektorin publik dhe privat, OShC-të nuk janë pjesë e kurrfarë përkrahje apo nxitje brenda këtyre programeve. Gjatë intervistave për këtë raport, KCSF ka kuptuar se Agjencia e Statistikave e Kosovës i ka disa statistika në lidhje me numrin e të punësuarve në sektorin jofitimprurës, edhe pse nuk ka kurrfarë kategorizimi të tyre. Sipas informatave të dhëna nga Agjencia e Statistikave e


²⁸ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

Kosovës, gjatë vitit 2013, 793 OJQ kanë deklaruar të kenë 6,589 punëtorë. Një numër i ngjashëm është dhënë gjithashtu edhe për vitet 2012 dhe 2011. Nuk ka informata në dispozicion në lidhje me të punësuarit me orar të plotë, të shkurtuar apo të jashtëm përbrenda këtij numri të përgjithshëm të punëtorëve.

Përmes një programi për vullnetarizën të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë angazhuar 99 vullnetarë të rinj gjatë 3 viteve, të cilat janë pajisur me certifikata, si dëshmi për njohjen e angazhimit si përvojë pune.

Nuk është bërë kurrfarë ndryshimi në kornizën ligjore për vullnetarizëm gjatë vitit 2014, edhe pse disa hapa janë ndërmarrë për ta adresuar këtë çështje në nivelin e politikave. Gjatë vitit 2014, Këshilli për Zbatimin e Strategjisë

qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile ka themeluar një grup punues për identifikimin e sfidave kyçe dhe çështjeve që duhen adresuar për përmirësimin e ambientit për vullnetarizëm në Kosovë. Ky ka qenë i vetmi zhvillim i raportuar në këtë fushë për vitin 2014, duke bërë që Kosova të mos ketë politika dhe ligje përkrahëse për vullnetarizëm. I vetmi ligj i cili përmban dispozita për vullnetarizmin mbetet Ligji 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë²⁹, i cili synon stimulimin e vullnetarizmit për rininë. Kategoritë e tjera nuk janë adresuar në asnjë ligj tjetër. Disa raporte sugjerojnë se mungesa e njohjes ligjore të vullnetarizmit është një nga arsyt e nivelit të ulët të punës vullnetare në Kosovë³⁰. Edhe sa i përket fushës së rinisë ka numër shumë të vogël të nxitjeve dhe programeve shtetërore për vullnetarizmin dhe vetëm një numër i vogël i OShC-ve kanë dijeni për këto programe. 92.7% të OShC-ve të anketuara deklarojnë se nuk kanë dijeni për ekzistencën e ndonjë programi shtetëror për përkrahje të vullnetarizmit. Regjistrimi i vullnetarëve të rinj është i obligueshëm, ashtu sikurse edhe obligimet për marrëdhënie kontraktuale dhe mbrojtjen për vullnetarizmin e organizuar rinor. Mirëpo, procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinor janë të komplikuar dhe të rënda për OShC-të, kështu që vullnetarizmi ndodh në forma të tjera, kryesisht pa kurrfarë procedure formale.



Për të përmbledhur, OShC-të nuk janë pjesë e politikave të cilat promovojnë punësim, dhe shteti nuk e nxit punësimin apo vullnetarizmin nëpër OShC.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 2.3 janë:

- Gjatë dizajnit të politikave të punësimit, shteti duhet të njoh se shoqëria civile është një prej sektorëve të cilët krijojnë punësim, kështu që duhen të përfshihen në programe shtetërore për nxitje të punësimit
- Një sistem gjithëpërfshirës për vullnetarizmin duhet të iniciohet, bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, me përfshirjen e fushave të tjera përtej vullnetarizmit rinor

²⁹ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2654>

³⁰ Indeksi për shoqërinë civile të Kosovës 2013, KCSF 2014.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Punës dhe Administrata Tatimore duhen t'i përfshijnë OShC-të si kategori statistikore nëpër statistikat e tyre të punësimit në pajtim me instrumentet e Organizatës Botërore të Punësimit (UN/ILO)

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
<p>1.2.a. Numri i punëtorëve në OShC (me orar të plotë dhe të shkurtuar)</p> <p>1.2.b. Numri i vullnetarëve në OShC për lloje të OShC-ve/sectorit</p> <p>1.2.c. Cilësia e kornizës legislative</p>	<p>Numri i punëtorëve në sektorin e OShC-ve, bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, është 6,589, të deklaruar nga 793 OJQ. Nuk janë dhënë detaje në lidhje me numrin e punëtorëve me orar të plotë apo të shkurtuar. OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me sektorët e tjerë përbrenda Ligjit të punës, derisa sektori i shoqërisë civile nuk është pjesë e politikave dhe programeve të cilat promovojnë punësimin.</p> <p>Numri i vullnetarëve në OShC nuk është në dispozicion. Përveç një numri të dispozitave në lidhje me vullnetarizmin rinor, nuk ekziston kurrfarë kornize ligjore për ta rregulluar dhe promovuar vullnetarizmin në shoqërinë civile. Si rezultat, në shumicën e rasteve vullnetarizmi ndodh në mënyrë joformale dhe të pastandardizuar.</p>

Fusha 3: Marrëdhëniet Qeveri-OSHC

Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 3.1.1.: Shteti, përmes politikave dhe strategjive, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektorin dhe Standardi 3.1.2.: Shteti, përmes funksionimit të institucioneve të tij, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektorin. Pasi që Standardi 3.1.1. ka qenë ai i cili ka pësuar zhvillimet më të shumta gjatë vitit 2014, ky standard i është shtuar 12 standardeve të përzgjedhura në Raportit për Kosovën 2014.

Zhvillimet e ndërlidhura me Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile kanë qenë ndër të paktat të cilat kanë vazhduar gjatë vitit 2014, përkundër krizës politike që ka zgjatur për një periudhë të gjatë të këtij viti. Një prej arsyeve për këtë ka qenë se shumica e vendimeve dhe proceseve të ndërlidhura me këtë Strategji janë në nivelin e nëpunësve civilë; së paku për fazat fillestare të zbatimit të saj. Kjo Strategji, e cila është miratuar në korrik të vitit 2013, nuk ka filluar të zbatohet deri në vitin 2014. Në vitin 2014 përqendrimi ka qenë në themelimin e trupave të domosdoshëm për zbatimin e saj, derisa shumica e aktiviteteve të ndërlidhura me përmbajtjen janë shtyrë për vitin 2015 e më tutje. Edhe pse Ministria e Financave, gjatë vitit 2014, ka ndarë një buxhet solid për zbatimin e kësaj Strategjie (137,960 EUR për 4 vite), vetëm një pjesë e vogël e këtij buxheti është shpenzuar deri më tani. Plani fillestar i veprimit për zbatimin e Strategjisë është ndryshuar dhe shumë aktivitete specifike pritet të fillohen gjatë vitit 2015 (një plan i hollësishëm për vitin 2015 është hartuar dhe miratuar nga Këshilli për zbatimin e Strategjisë në dhjetor të vitit 2014). Shoqëria civile ka qenë drejtpërdrejt e përfshirë në rishikimin e këtij plani të veprimit. Një sistem i monitorimit, si pjesë e punës së Këshillit për zbatimin e strategjisë, është planifikuar të dizajnohet gjatë vitit 2015. Zyra për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit, e cila ka mandat të shërbejë si Sekretariat i Këshillit, e ka detyrën ta dizajnojë dhe zbatojë këtë sistem të monitorimit.

Viti 2014 gjithashtu është viti që karakterizohet me dokumentin e parë për bashkëpunim me shoqërinë civile të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deklarata për partneritet në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile³¹ është miratuar në fillim të vitit 2014, dhe përmbajtja e kësaj deklarate është zhvilluar në bashkëpunim me OSHC-të aktive në nivel të Kuvendit. Për shkak të mungesës së Kuvendit gjatë pjesës më të madhe të vitit 2014, kjo Deklaratë ende nuk ka dhënë ndonjë rezultat konkret. Një grup i përbashkët me shoqërinë civile pritet të themelohet nga Kuvendi gjatë vitit 2015 e që synon dizajnimin e aktiviteteve specifike për zbatimin e kësaj Deklarate.

Edhe pse rregullimi institucional për bashkëpunim me shoqërinë civile mbetet kryesisht i pandryshuar, është vërejtur një lloj përparimi gjatë vitit 2014. Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) vazhdon të jetë njësi qendrore me mandat të lehtësimit të bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile – roli i Sekretariatit të Këshillit vetëm se i shtohet mandatit të saj për bashkëpunim me këtë sektor. Në mënyrë që ta kryej këtë detyrë më mirë, ZQM/ZPM ka rekrutuar dy zyrtarë për t'i angazhuar kryesisht në detyra të ndërlidhura me zbatimin e Strategjisë. Sa i përket numrave, rekrutimet e reja paksa e adresojnë sfidën afatgjatë të burimeve njerëzore të pamjaftueshme

³¹ http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Declaration_Assembly_Society.pdf

për ta kryer mandatin e saj të mjaft të gjerë. Mirëpo, ende mbetet të vlerësohet se a do të përkthehet rritja e numrit të stafit në rritje të cilësisë së punës së ZQM/ZKM-së. Pjesa e parë e vitit 2014 është karakterizuar me hartimin e vendimeve të nevojshme për themelimin dhe rregullat procedurale të Këshillit për zbatimin e strategjisë, derisa gjatë pjesës së dytë të vitit, Këshilli është funksionalizuar dhe është ndërmarrë një punë intensive gjatë çerekut të fundit të vitit. Nga 29 anëtarë të këtij Këshilli, 15 prej tyre janë përfaqësues të shoqërisë civile, ku 14 prej tyre janë zgjedhur përmes një procedure të hapur dhe demokratike derisa një është emëruar nga Platforma Civikos. Gjatë verës së vitit 2014, Platforma Civikos ka organizuar me sukses një proces të nominimit dhe zgjedhjes së 14 përfaqësuesve të OShC-ve në këtë trup të përbashkët. Një institucion tjetër i cili është mandatuar me detyra specifike në lidhje me sektorin e OShC-ve e ka ngushtuar mandatin e tij gjatë vitit 2014. Departamenti për OJQ përbrenda Ministrisë së Administratës Publike, i cili është autoriteti kompetent për regjistrimin e OJQ-ve dhe Statusit për Përfitim Publik, e ka hequr rolin e saj të “ndërlidhësit” nga mandati dhe emri i saj – rol ky të cilin gjithsesi se nuk e kryer. Sidoqoftë, kapacitetet e Departamentit për OJQ ende mungojnë për t’i kryer të gjitha detyra e ndërlidhura me regjistrimin e OJQ-ve, funksionimin e tyre dhe Statusin për Përfitim Publik. Në nivel të Kuvendit të Kosovës, Zyrtari për shoqëri civile ka vazhduar punën edhe pse nuk është raportuar kurrfarë rezultati konkret nga kjo pozitë e themeluar në vitin 2013. Mungesa e një Kuvendi funksional gjatë pjesës më të madhe të vitit 2014 ka qenë një prej faktorëve kontribuues për këtë. Në përgjithësi, mbetet brengosëse qasja shumë e kufizuar e këtyre institucioneve drejt shoqërisë civile. Siç është treguar nga rezultatet e sondazhit për vitin 2014, bashkëpunimi i tyre me shoqërinë civile duket të jetë i kufizuar vetëm nëpër procese/iniciativa specifike, gjë që rezulton që pjesa më e madhe e sektorit të mos jenë fare të përfshirë në bashkëpunim apo aspak të mos kenë dijeni për ekzistencën e këtyre institucioneve. Shumica e OShC-ve të anketuara deklarojnë se nuk kanë bashkëpunuar kurrë me këto institucione, derisa disa prej OShC-ve nuk kanë dëgjuar kurrë për to.

Për të përmbledhur, është arritur një lloj përparimi sa i përket dokumenteve kornizë dhe institucioneve për bashkëpunim me shoqërinë civile, në nivelin qeveritar dhe të Kuvendit. Sidoqoftë, ende ka shumë pak apo nuk ka fare rezultate konkrete si rezultat i këtyre dokumenteve. Burimet e kufizuara njerëzore dhe kapacitetet e këtyre institucioneve nuk garantojnë se miratimi i dokumenteve do të zbatohet si duhet në praktikë.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.1 janë:

- **Qeveria duhet të filloj me zbatimin më dinamik të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, përfshirë këtu ndërtimin e një sistemi të monitorimit dhe zbatimin e tij;**
- **Kuvendi i Kosovës duhet të përcaktojë mekanizmat konkret të bashkëpunimit dhe përfshirjes së OShC-ve në punën e Kuvendit, bazuar në Deklaratën e miratuar në vitin 2014;**
- **Institucionet e ngarkuara për bashkëpunim me shoqërinë civile në nivelet e Qeverisë dhe të Kuvendit duhen ta zgjerojnë qasjen e tyre dhe t’i afrohen më shumë sektorit të shoqërisë civile.**

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
3.1.b Cilësia* e strukturave dhe mekanizmave ekzistues për dialog dhe bashkëpunim në mes të	Strukturat dhe mekanizmat për dialog dhe bashkëpunim në mes të OShC-ve dhe institucioneve publike kanë parë përparim gjatë

OSHC-ve dhe institucioneve publike

* sa i përket:

- përfaqësimit të OSHC-ve në përgjithësi
- përfaqësimit të OSHC-ve më të vogla/më të dobëta
- dukshmërisë dhe disponueshmërisë të saj
- perceptimit qeveritar të cilësisë së strukturave dhe mekanizmave
- perceptimit të OShC-ve për cilësi dhe mekanizma

vitit 2014. Këshilli për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është themeluar dhe funksionalizuar gjatë vitit 2014. Përmes një procedure të hapur, transparente dhe demokratike, përfaqësues të shoqërisë civile janë përzgjedhur në këtë Këshill dhe përfaqësimi i sektorit është i shumëllojshëm. Të gjitha dokumentet dhe zhvillimet në lidhje me Këshillin janë publikuar në një faqe specifike të internetit, e cila menaxhohet nga Sekretariati i Këshillit. Sidoqoftë, zbatimi i masave konkrete të Strategjisë është vonuar dhe ende nuk mund të raportohen rezultate të kësaj Strategjie.

Një Deklaratë për partneritet në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile është miratuar në fillim të vitit 2014, dhe përmbajtja e kësaj Deklarate është hartuar në bashkëpunim me OShC-të aktive në nivel të Kuvendit. Mirëpo, ende nuk ka rezultate konkrete të raportuara nga kjo deklaratë.


Për më tepër, qasja e institucioneve përgjegjëse për bashkëpunim me shoqërinë civile është e kufizuar dhe një pjesë mjaft domethënëse e OShC-ve nuk bashkëpunojnë me këto institucione.

Nënfusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 3.2.1: Ekzistojnë standardet që mundësojnë përfshirjen e OShC-ve në vendimmarrje, që ua mundëson atyre dhënien e komenteve dhe kontributit me kohë; Standardi 3.2.3: Përfaqësuesit e OShC-ve janë partnerë të barabartë në trupat ndërsektoriale dhe zgjedhen përmes kriterëve dhe proceseve të përcaktuara qartazi.

Nuk ka pasur ndryshime të shumta në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes, dhe përfshirja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes mbetet e ulët. Korniza ligjore për përfshirjen e OShC-ve në vendimmarrje nuk i është nënshtruar kurrfarë ndryshimi. Ajo ekzistuese u jep mundësi të shumta OShC-ve të japin kontributet e tyre në të dy nivelet e qeverisjes, mirëpo mangësitë në zbatimin e drejtë dhe mungesa e standardeve konkrete nuk u mundëson OShC-ve të japin kontributin e tyre në kohën e duhur. Konkretisht, Rregullorja e punës së Qeverisë³² kërkon konsultime publike për të gjitha projekt-ligjet/politikat, ofrim të informatave të mjaftueshme dhe të përshtatshme nga ana e autoritetit propozues, si dhe informata kthyesë për rezultatet e konsultimit.


³² <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10543>



Mirëpo, pasi që nuk ka standarde për zbatimin e përshtatshëm të këtyre dispozitave, këto kërkesa zbatohen vetëm pjesërisht. Vetëm 4.87% të OShC-ve të anketuara besojnë së institucionet publike i ftojnë rregullisht të gjitha OShC-të e interesuara që të komentojnë në

iniciativa për politika/ligje në fazë të hershme. Rezultatet janë të ngjashme edhe për informatat në lidhje me përmbajtjen e dokumenteve, informatave kthyesë me shkrim për rezultatet e konsultimeve dhe kapacitetet e shërbyesve civil përgjegjës për konsultim publik. Standardet minimale të propozuara për konsultime publike do të trajtohen nga Qeveria gjatë vitit 2015 dhe ky definim i obligimeve të hollësishme për institucionet publike pritet ta rris nivelin e zbatimit të obligimeve të tashme në nivelin e Qeverisë.

Rregullorja e punës së Kuvendit nuk është ndryshuar dhe ajo përmban dispozita jobligative për të ftuar OShC-të dhe për të organizuar dëgjime publike. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta në dispozicion, tashmë për shumë vite Komisionet



parlamentare organizojnë dëgjime publike vetëm për një numër të caktuar të ligjeve. Pasi që Kuvendi i Kosovës ka qenë funksional për më pak se gjysmë viti, gjatë vitit 2014 është mbajtur vetëm një numër i vogël i dëgjimeve publike. Ngjashëm, nuk është bërë kurrfarë ndryshimi as në nivelin lokal. Ligji për vetëqeverisje lokale³³ ofron instrumente të ndryshme të pjesëmarrjes së publikut në nivelin lokal, duke përfshirë konsultimet publike, komisionet sektoriale konsultative, peticionet, takimet publike me kryetarin e komunës, etj. Mirëpo shumica e komunave nuk e përfshijnë shoqërinë civile rregullisht dhe shumë instrumente ligjore ekzistuese nuk janë të funksionalizuara si duhet. Sa i përket kapaciteteve të nëpunësve civilë për ta përfshirë shoqërinë civile, gjatë vitit 2014 nuk ka pasur programe edukimi/trajnimi për ta lidhur me këtë çështje. Një numër i kufizuar i trajnimeve janë organizuar kryesisht nga shoqëria civile dhe ka shumë pak nëpunës civilë që janë përgjegjës për hartimin e politikave publike e të cilët kanë kryer ndonjë program të edukimit/trajnim për përfshirjen e OShC-ve. Të kontaktuar për qëllime të këtij raporti, institucioni i mandatuar për ngritje të kapaciteteve të nëpunësve civilë – Instituti Kosovar për Administratën Publike – ka konfirmuar se nuk ka module të trajnimit për konsultime publike apo çfarëdo teme tjetër të ndërlidhur me përfshirjen e OShC-ve në punën e institucioneve publike. Së

³³ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

fundi, me përjashtim të Kuvendit të Kosovës, institucionet e tjera nuk kanë njësi specifike/zyrtarë, të cilët e koordinojnë dhe monitorojnë procesin e konsultimit publik. Në Ministri, procesi i konsultimit publik zakonisht udhëhiqet nga departamentet e tyre ligjore, derisa nëpër komuna ka praktika të ndryshme të punës.

Nuk ka pasur ndryshime as në kornizën ligjore për qasje në dokumente publike, edhe pse diskutimet për këtë kanë qenë pjesë e një numri të konferencave të organizuara gjatë vitit 2014. Qasja në informata publike është e drejtë kushtetuese, e garantuar përmes nenit 41 të Kushtetutës. Ligji 03/L-215 për qasje në dokumente publike³⁴ i obligon të gjitha institucionet që në formë proaktive të publikojnë të gjitha dokumentet e miratuara, por nuk kërkon në mënyrë të qartë publikimin e drafteve të dokumenteve në procedurë. Si rezultat, nuk ka qasje të lehtë të publikut në shumicën e projekt-ligjeve dhe politikave në kohën e duhur. Një udhëzim administrativ në lidhje me përmbajtjen e faqeve të internetit të Ministrive gjithashtu liston edhe “dokumentet në procedurë” të publikohen në faqet e tyre të internetit. Mirëpo, vetëm 11.8% të OSHC-ve të anketuara cilat kanë marrë pjesë në procesin e hartimit deklarojnë se i kanë pranuar draftet e dokumenteve nga faqet e internetit të ministrive. Shumicën e kohës, këto dokumente bëhen publike pas kërkesës apo shpërndahen përmes Platformës CiviKos. Kur flasim për kërkesa për qasje në dokumente publike, ka procedura dhe mekanizma ligjor të definuar qartë për qasje në informata/dokumente publike, edhe pse procedurat administrative jo gjithmonë i përmbushin kërkesat ligjore. Në praktikë, numri i kërkesave zyrtare nga shoqëria civile nuk është i madh dhe institucionet publike nuk u përgjigjen atyre rregullisht përbrenda afatit kohor prej 7 ditë pune. Sipas raportit të vitit 2013 të Zyrës së Kryeministrit, përqindja e kërkesave të përmbushura ka arritur në 91.7%, derisa ka gjithashtu edhe rritje në përqindjen e kërkesave të papërgjegjura në 3.2 %. Tek niveli qendror shumica e kërkesave vijnë nga qytetarët dhe gazetarët, derisa shoqëria civile merr pjesë me vetëm 6.9% në totalin e kërkesave të përgjithshme në nivelin qendror. Në nivelin lokal, shoqëria civile është aktori më aktiv me 37% të kërkesave, ndjekur nga gazetarët me 26.4%.³⁵ Një prej problemeve kyçe mbetet refuzimi i bërë përmes heshtjes administrative, si dhe rastet e rralla kur refuzimet përcillen me shpjegim të shkruar për arsyet e refuzimit. Ligji për Qasje në Dokumente Publike përmban sanksione monetare të përshkruara qartë për nëpunësit civil dhe institucionet të cilat shkelin kërkesat ligjore për qasje në informata publike, mirëpo nuk ka pasur raporte se rastet e shkeljeve të ligjit janë ndëshkuar nga asnjë nivel i qeverisjes.

Disa trupa ndërsektoral janë themeluar gjatë vitit 2014 dhe ato ekzistuese kanë qenë më pak aktive, për shkak të bllokadës politike të vitit 2014. Legjislacioni në nivelin e qeverisë lejon, por nuk e obligon Qeverinë t'i ftoj përfaqësuesit e OShC-ve në vendimmarrje apo trupa këshillëdhënës të krijuar nga institucionet publike. Ka shumë trupa vendimmarrës dhe këshillëdhënës të cilët i përfshijnë përfaqësuesit e OShC-ve në nivele të ndryshme të qeverisjes, siç është Këshilli Kombëtar për Integritet Europian apo Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit. Si përjashtim, komitetet këshillëdhënëse sektorale në nivel komunal duhen të themelohen dhe të përbëhen nga qytetarë dhe shoqëria civile, mirëpo vetëm një numër i vogël i komunave e kanë përmbushur këtë obligim. Nuk ka udhëzues apo mekanizma standard të përzgjedhjes, të cilët do të siguronin përfaqësimin e duhur nga shoqëria civile. Sidoqoftë, themelimi i Këshillit për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile ishte një shembull shumë i mirë i punës së përbashkët dhe mekanizmave të përzgjedhjes. Me përjashtim të këtij Këshilli, përfaqësuesit e OShC-ve shumë rrallë zgjedhën nëpër shumë trupa ndërsektoral bazuar në kriteret dhe

³⁴ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

³⁵ Raporti vjetor për të drejtën e qasjes në dokumente publike i vitit 2013, Zyra e Kryeministrit, 2014. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti_Gjithperfshires_Final_Shqip_7_Prill.pdf

proces të definuar qartë. Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshillin Prokurorial të Kosovës kryesisht është kritikuar nga shoqëria civile pasi që nuk i ka përmbushur obligimet ligjore për një proces të hapur të nominimit dhe përzgjedhjes. Mekanizmi përzgjedhës i aplikuar për Këshillin për zbatimin e Strategjisë mund të përshtatet dhe të shfrytëzohet gjithashtu për trupa dhe forume të ngjashme. Në përgjithësi, përfaqësuesit e OShC-ve në këta trupa janë të lirë të përfaqësojnë dhe mbrojnë pozitën e tyre, pa u sanksionuar. Ngjashëm, shumica e OShC-ve që kanë marrë pjesë në trupa vendimmarrës dhe këshillëdhënës shfrytëzojnë mënyra alternative të avokimit, të cilat jo domosdoshmërisht janë në linjë me pozitën e trupit përkatës.

Për të përmbledhur, mund të thuhet se mundësitë ligjore për përfshirjen e OShC-ve në proceset e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes nuk shfrytëzohen si duhet, kryesisht për shkak të zbatimit të dobët nga ana e autoriteteve publike.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.2 janë:

- Aktet normative për standardet minimale për konsultime publike në nivelin e Qeverisë duhen të miratohen dhe zbatohen, bazuar në propozime nga shoqëria civile;
- Mekanizma të përgjithshëm për përzgjedhje duhen të dizajnohen nga Qeveria në mënyrë që t'u mundësohet të gjitha institucioneve publike t'i aplikojnë ato me përshtatjet e duhura. Modeli i përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë duhet të konsiderohen për t'u përdorur nga të gjithë trupat vendimmarrës dhe këshillëdhënës;
- Kuvendi i Kosovës duhet ta bëjë obligative përfshirjen e OShC-ve në punën e Komisioneve parlamentare, derisa këto të fundit duhen të organizojnë dëgjime publike për të gjitha projektligjet në procedurë;
- Ligji për qasje në dokumente publike duhet të ndryshohet në mënyrë që t'i obligoj institucionet publike t'i publikojnë në mënyrë proaktive draftligjet/politikat dhe iniciativat për politika;
- Institucionet publike, përfshirë Institutin Kosovar për Administratën Publike, duhet të bashkëpunojnë me shoqërinë civile në ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil në përfshirje të OShC-ve.

Indikatorët e Udhëzuesit të BE-së	Vlerësimi i Matricës së monitorimit
<p>3.1.a. Përqindja e ligjeve/akteve nënligjore, strategjive dhe reformave të politikave të cilat janë konsultuar në mënyrë efektive* me OShC-të</p> <p>* në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qasje të përshtatshme në informata - kohë të mjaftueshme për të komentuar - përzgjedhje të përfaqësuesve / shumëllojshmërisë së grupeve punuese - njohjen e kontributit të shoqërisë civile 	<p>Ekzistojnë kërkesa ligjore për konsultim me OShC-të në nivelin e Qeverisë, derisa në nivelin e Kuvendit dispozitat ligjore nuk janë obliguese. Sidoqoftë, mundësitë ligjore nuk shfrytëzohen si duhet, kryesisht për shkak të zbatimit të dobët nga ana e autoriteteve publike. Përkundër disa rasteve pozitive, në shumë raste qasja në informata nuk është adekuate, njëjtë si edhe koha për të komentuar. Nuk ka mekanizma standard të përzgjedhjes, edhe pse një rast i procedurës së përzgjedhjes së hapur dhe transparente është raportuar në vitin 2014. Njohja e kontributit të shoqërisë civile dhe publikimi i rezultateve të</p>


- shkallën në të cilën kontributet merren parasysh
 - informatat kthyes / publikimin e rezultateve të konsultimit

konsultimit nuk është diçka e zakonshme. Së fundi, për shkak të mungesës së monitorimit sistematik, nuk ka të dhëna të sakta në dispozicion në lidhje me **përqindjen e ligjeve/akteve nënligjore, strategjive dhe reformave të politikave të cilat në mënyrë efektive janë konsultuar me OShC-të.**

Nënfusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Kjo nënfushë është vlerësuar bazuar në standardet e përzgjedhura në vijim: Standardi 3.3.1: OShC-të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata shtetërore në baza të barabarta me ofruesit e tjerë të shërbimeve.

Ngjashëm me nënfushat e tjera të matricës, shumë pak zhvillime janë raportuar gjatë vitit 2014 në bashkëpunimin për ofrimin e shërbimeve në mes të institucioneve qeveritare dhe ofruesve të shërbimeve.



Në Kosovë, vetëm një numër i kufizuar i OShC-ve janë të përfshira në ofrimin e shërbimeve të ndryshme të cilat paguhen nga fondet shtetërore – shumica e shërbimeve të ofruara nga shoqëria civile ende financohen nga donatorë ndërkombëtarë. Ligji 04/L-042 për prokurimin publik³⁶ lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme, edhe pse ka disa barrierë ligjore të fshehta, të cilat në disa raste i ndalojnë OShC-të të jenë të pranueshme për kontrata për ofrimin e shërbimeve.

Për shembull, e vetmja certifikatë e regjistrimit e përshtatshme sipas ligjit është “certifikata e vlefshme e regjistrimit e lëshuar nga autoriteti publik përgjegjës për regjistrimin e organizatave të biznesit në Kosovë”. Pasi që certifikatat për OJQ lëshohen nga Departamenti i OJQ-ve, ky nen le të kuptohet se OJQ-të nuk janë të pranueshme për fitimin e kontratave publike. Edhe pse ka kërkesa ligjore të barabarta për të gjitha subjektet ligjore, përfshirë OShC-të, këto dispozita nuk janë në linjë me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Situata është tjetër në lidhje me shërbimet sociale, të cilat rregullohen përmes Ligjit 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare³⁷ (dhe ndryshimet e tij)³⁸, të cilat formalisht e njohin mundësinë dhe lejojnë që shërbime të ndryshme sociale të jepen nga OShC-të. Në këtë Ligj merret parasysh natyra specifike e punës së OShC-ve, kështu që nuk ka barrierë të fshehta të cilat janë pjesë e legjislacionit. Për më tepër, në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, gjatë vitit 2014 janë ndërmarrë hapa shtesë në definimin e standardeve dhe licencimin. Kështu, 25 standarde tashmë janë përcaktuar dhe procesi i licencimit të individëve veçse ka filluar, derisa licencimi i OShC-ve për këto standarde pritet të fillojë gjatë vitit 2015. Në praktikë, ka pak OShC të cilat janë të gjendje të pajisen me kontrata për shërbime, dhe shumica e tyre janë në fushën e shërbimeve sociale dhe fusha ku nuk ekzistojnë ofrues tjerë të shërbimeve. Një numër shumë i vogël i OShC-ve janë përfshirë në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve, edhe pse përfshirja e plotë e tyre në të tërë ciklin nga planifikimi deri te vlerësimi ende është me vonesë. Për OShC-të të cilat ofrojnë shërbime sociale, nevojitet regjistrimi dhe licencimi paraprak dhe procedura për tu pajisur me licencë është e njëjtë me ofruesit e tjerë të shërbimeve. Duke qenë një prej objektivave strategjike të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, hapja e sektorit të


³⁶ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

³⁷ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

³⁸ <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2808>

ofrimin të shërbimeve për shoqërinë civile ka qenë një prej objektivave më të vështira të kësaj Strategjie. Kjo për shkak të gamës së fushave që duhen adresuar, si dhe për shkak të mungesës së ekspertizës në të dyja anët – qeveri dhe shoqëri civile. Gjatë vitit 2014, një grup punues për këtë çështje është themeluar nga Këshilli për zbatimin e Strategjisë, edhe pse masat specifike ende nuk janë krijuar.

Për të përmbledhur, me përjashtim të ofrimin të shërbimeve sociale, pjesa tjetër e ambientit për ofrim të



shërbimeve në përgjithësi është e mbyllur për OShC-të dhe nuk u mundëson OShC-ve të bëhen ofrues të barabartë të shërbimeve. Edhe pse është një prej objektivave kryesore të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, mungesa e ekspertizës në të dyja anët e bën këtë të jetë një prej fushave më të vështira për reformim.

Rekomandimet kryesore për nënfushën 3.3 janë:

- Ligji për Prokurimin Publik duhet të amandamentohet në atë mënyrë që të lejojë certifikatat e regjistrimit të OShC-ve të pranohen, njëjtë si certifikatat e regjistrimit të biznesit;
- Institucionet publike duhen të ndërtojnë ekspertizën dhe burimet njerëzore të duhura për zhvillimin e një baze ligjore për ofrim të shërbimeve nga OShC-të, e cila do të duhej të jetë në linjë me parimet e caktuara në Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Të gjeturat dhe rekomandimet (forma tabelore)

Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive

Nënfusha 1.1.: Liria e asociimit

Parimi: Liria e asociimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARDI 2	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>OShC-të punojnë lirshëm, pa ndërhyrjen e paarsyeshme të shtetit në drejtimin e dhe aktivitetet e tyre të brendshme</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Korniza ligjore ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jofitimprurëse. 2) Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrja e palëve të treta. 3) Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pastrimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit merr parasysh natyrën specifike të OShC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin/qëllimin e aktiviteteve të saj. 4) Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit. 5) Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kriteret objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore ndalon autoritetet publike të ndërhyjnë në punën dhe aktivitetet e OJQ-ve. Mirëpo, legjislacioni dytësor i miratuar në shtator të vitit 2014, përmes dispozitave specifike për pezullimin e OJQ-ve, lejon autoritetet publike të ndërhyjnë në punën dhe aktivitetet e OJQ-ve. • Nuk ekzistojnë dispozita specifike ligjore për mbrojtjen shtetërore nga ndërhyrja e palëve të treta në ushtrimin e lirisë së asociimit • Vetëm organizatat me SPP me të ardhura më të larta se 100,000 EUR duhen të dorëzojnë raport të auditimit të jashtëm • Korniza ligjore për raportim financiar të OShC-ve është e ngjashme me kompanitë private dhe nuk e merr parasysh madhësinë dhe llojin/fushën e aktivitetit të OShC-ve. • Procesi i iniciuar kohëve të fundit për amendamentimin e ligjeve fiskale nuk përfshinë përfaqësues të shoqërisë civile • Rregullat për pastrimin e parave kanë pragje më 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të bëhet një shqyrtim thellësor i Ligjit për OJQ, që ka për synim identifikimin e zbrazëtirave ligjore dhe sfidave të zbatimit, dhe një proces i amendamentimit duhet të iniciohet bazuar në rezultatet e këtij shqyrtimi • Neni 18 i Rregullores për Regjistrimin e OJQ-ve, i cili lejon pezullimin e OJQ-ve nga Departamenti i OJQ-ve, duhet të hiqet • Korniza ligjore për raportimin financiar të OShC-ve duhet të ndryshohet që ta marrë parasysh natyrën specifike të OSHC • Ligji për pastrimin e parave

		<p>të ulëta të raportimit për OShC-të në krahasim me subjektet e tjera dhe konsiderohen të jenë të rënda për funksionimin e përditshëm të OShC-ve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sanksionet për shkeljen e rregullave të pastrimit të parave nuk janë proporcionale me nivelin e shkeljes dhe nuk janë në përputhje me dispozitat e shuarjes së OJQ-ve të Ligjit për liri të asociimit në OJQ. • Sanksionet për raportimet tatimore janë të ngjashme me kompanitë private dhe proporcionaliteti i njëjtë aplikohet gjithashtu për OShC-të • Rregullat e shuarjes së OJQ-vë janë në përputhje me ligjet ndërkombëtare dhe të bazuara në kritere objektive, përveç dispozitave të Ligjit për pastrim të parave dhe legjisllacionit dytësor, të miratuar në shtator të vitit 2014 i cili mundëson pezullimin e një OJQ nga ana e një njësie administrative të qeverisë • Rregullat për themelimin dhe procedurat e Komisionit për shpërndarje të aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara nuk ekzistojnë 	<p>duhet të ndryshohet dhe të hiqen të gjitha dispozitat kufizuese për OJQ-të, përfshirë kërkesat për autorizim paraprak për pranimin dhe shpërndarjen e fondeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sanksionet për shkeljen e rregulloreve për pastrim të parave duhet të hiqen dhe nuk duhet të ketë fare sanksione specifike për OJQ-të • Rregullat për themelimin dhe procedurën e Komisionit për shpërndarje të aseteve të OJQ-ve të shuara duhen të hartohen, në bashkëpunim me OShC-të
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste të ndërhyrjes shtetërore në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Nuk ka praktika të mbikëqyrjes arbitrare të cilat të imponojnë kërkesa të rënduara raportimi. 3) Sanksionet aplikohen në raste të rralla/ekstreme, ato janë proporcionale dhe janë subjekt i një shqyrtimi gjyqësor 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 14 OJQ janë pezulluar nga Departamenti i OJQ-ve bazuar në legjisllacionin dytësor të miratuar në shtator të vitit 2014, me bazë se aktivitetet e këtyre organizatave kanë qenë kundër rregullimit ligjor dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe të drejtës ndërkombëtare. • Më shumë se gjysma e OShC-ve konsiderojnë se kërkesat e raportimit financiar nuk përputhen me natyrën specifike të OShC-ve • Shumica e OShC-ve raportojnë se nuk kanë pasur vizita nga autoritetet tatimore gjatë vitit 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pezullimi i OJQ-ve nga Departamenti i OJQ-ve duhet të hiqet dhe çfarëdo procedure në vijim në këto raste duhet të bazohet në legjisllacionin e aplikueshëm • Administrata Tatimore e Kosovës dhe Ministria e Financave duhet të

		<p>2014. Vetm një prej OSHC-ve të anketuara ka raportuar “vizita të papritura” nga autoritetet tatimore gjatë vitit 2014, dhe një OSHC tjetër ka raportuar se është ndërmarr inspektim i tepruar nga autoritetet tatimore gjatë një vizite të lajmëruar. Sanksionet për OSHC nuk janë të zakonshme dhe nuk është mbledhur asnjë dëshmi e sanksioneve joproporcionale</p>	<p>inicojnë një proces të dialogut me shoqërinë civile për të identifikuar problemet dhe nevojat specifike të sektorit në lidhje me raportimin financiar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës duhen të ngritën në mënyrë që të kuptohet dhe adresohet si duhet natyra specifike e punës së OSHC-ve • Autoritetet tatimore duhen të hartojnë udhëzues lehtë të përdorshëm dhe të mbajnë trajnime për OShC-të që t'i ndihmojnë të gjitha OShC-të t'i përmbushin kërkesat e raportimit
--	--	--	---

Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive

Nënfusha 1.1.: Liria e asociimit

Parimi: Liria e asociimit është e garantuar dhe ushtrohet lirshëm nga të gjithë

STANDARDI 3	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>OShC-të lirshëm mund të kërkojnë dhe sigurojnë burime financiare për ta përkrahur veprimtarinë e tyre nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni lejon OShC-të të angazhohen në aktivitete ekonomike. 2) OShC-të lejohen të pranojnë fonde të huaja. 3) OShC-të lejohen të pranojnë fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore lejon OShC-të të merren me • aktivitete ekonomike • Korniza ligjore lejon OShC-të të pranojnë fonde nga jashtë • Korniza ligjore lejon OShC-të të pranojnë fonde nga individët, korporatat dhe nga burime të tjera, edhe pse ligji për pastrimin e parave kufizon shumat e pranimit dhe shpërndarjes pa autorizim paraprak • Korniza ligjore për lirim nga taksat doganore nuk është e qartë dhe organizatat me SPP nuk trajtohen në mënyrë standarde 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lirimet nga taksat doganore duhet t'u mundësohet të gjitha organizatave me SPP ndërsa procedurat e liritimit duhet të thjeshtohen • Kufizimet për pranim dhe shpërndarje të fondeve në ligjin për pastimin e parave duhen të hiqen
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni për OShC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OShC-të. 2) Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, para-miratime, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OShC-të për të marrë fonde të huaja. 3) Marrja e fondeve nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në praktikë, numër i vogël i OShC-ve merren me aktivitete ekonomike. 17.1% e OSHC-ve të anketuara raportojnë se ata merren me aktivitete ekonomike dhe 4.9% se ballafaqohen me vështirësi gjatë marrjes me aktivitete ekonomike • OShC-të nuk janë të njoftuar me obligimet dhe kufizimet për aktivitete ekonomike dhe nuk ka këshillim ligjor në dispozicion • Nuk janë raportuar kufizime në pranimin e financimit nga jashtë, me përjashtim të Ligjit 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Periudha për lirim nga TVSH për një pjesë specifike të financimit të huaj duhet të vazhdohet urgjentisht • Procedura për lirim nga TVSH duhet të unifikohet për të gjithë donatorët e liruar, me qëllim të zbatimit të procedurave të tilla nga OShC-të

		<p>kundër pastrimit të parave dhe procedurave të rënda</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lirimi nga TVSh është dhënë duke u bazuar nga lloji i donatorit dhe aplikohen procedura të ndryshme. Disa procedura për lirimin janë të rënda dhe të vështira të zbatohen. • Periudha gjatë të cilës disa fonde të huaja janë të liruara nga TVSh ka përfunduar me 31 dhjetor të vitit 2014 dhe vazhdimi i saj nuk ende është miratuar nga Kuvendi i Kosovës • Për lirim nga dogana të bazuar nga lloji i donatorëve, kompetencat janë bartur plotësisht tek Doganat e Kosovës dhe nuk duhet të lëshohet asnjë “urdhërblerje për lirim” nga Administrata Tatimore e Kosovës • OShC-të janë të lira të marrin financim nga burime të ndryshme private, me përjashtim të kufizimeve dhe procedurave të rënda të parapara në Ligjin kundër pastrimit të parave 	<ul style="list-style-type: none"> • Deri sa të amendamentohet Ligji kundër pastrimit të parave, autoritetet kompetent duhen ti informojnë të gjitha OShC-të aktive për obligimet e tashme
--	--	---	---

Fusha 1: Garancitë themelore ligjore të lirive

Nënfusha 1.2.: Liritë e tjera

Parimi: Liria e tubimit dhe shprehjes janë të garantuara për të gjithë

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
-------------	-----------	-------------	-----------------------------

<p>Përfaqësuesit e OShC-ve, qoftë individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e tubimit paqësor</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Korniza ligjore është e bazuar në standardet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e tubimit për të gjithë pa kurrfarë diskriminimi. 2) Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë tubimet spontane, të njëkohëshme dhe kundër-tubimet. 3) Për ushtrimin e të drejtës së tubimit nuk kërkohet autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta një procedurë e njoftimit paraprak, e cila nuk është e rëndë. 4) Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apelohej nga organizatorët. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore u garanton të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës të drejtën të organizojnë dhe marrin pjesë në tubime publike • Korniza ligjore nuk përmban dispozita ligjore në lidhje me të drejtën për tu tubuar për ata të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës • Korniza ligjore në mënyrë indirekte lë të kuptohet se kundër-tubimet nuk janë të lejuara • Korniza ligjore kërkon njoftim paraprak për tubime publike, përveç në ato vende ku nuk kërkohen masa shtesë sigurie (stadiume etj.) dhe/apo objekte të mbyllura. Në raste kur nuk është dhënë përgjigje nga autoritet përbrenda kohës së duhur, tubimi publik mund të mbahet pa asnjë kufizim • Për çfarëdo kufizimi pas njoftimit për tubim publik organizatorët mund të bëjnë ankesë në gjykatë përmes procedurës së shpejtë 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Korniza ligjore duhet ndryshuar që të lejojë të drejtën e tubimit edhe për josh tetas të Kosovës, si dhe të lejojë kundër-tubimet
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore. 2) Kufizimet janë të justifikuara me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e ankesës. 3) Tubimet e njëkohëshme dhe spontane mund të mbahen dhe shteti lehtëson dhe mbron grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen. 4) Ka raste të ushtrimit të lirisë së tubimit nga OShC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, ndërsa në rastet kur nevojitet njoftimi ai dorëzohet në një periudhë të 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • OShC-të nuk raportojnë asnjë kufizim të drejtës së tyre për tu tubuar. Tubimet publike zakonisht janë të organizuara nëpër sheshe publike, derisa vendet tjera nuk janë të zakonshme për organizimin e tubimeve publike • Kundërtubimet nuk janë të zakonshme • Vetëm 24.2% të OSHC-ve të anketuara kanë raportuar të kenë qenë të përfshira në organizimin e tubimeve, dhe asnjë prej tyre nuk ka raportuar ndonjë kufizim • Gjatë vitit 2014 është raportuar vetëm një rast i intervenimit të policisë. Policia ka intervenuar gjatë protestave të organizuar nga shoqatat studentore dhe të përkrahura nga OSHC tjera, ku është kërkuar dorëheqja e Rektorit të 	<p>Praktika:</p>

	<p>shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar tubimin.</p> <p>5) Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve.</p> <p>6) Mediet duhet të kenë qasje sa më të madhe nëpër tubime.</p>	<p>Universitetit të Prishtinës. Në mes të 33 protestuesve të arrestuar ka pasur gjithashtu edhe aktivistë të shoqërisë civile, përfshirë një drejtor të një OSCH-je mjaft të njohur.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në përgjithësi, mediat kanë qasje të plotë në tubime 	
--	--	---	--

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC-të dhe donatorët e tyre

Parimi: OShC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Lehtësirat tatimore janë në dispozicion për burime të ndryshme të të hyrave të OShC-ve</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji parashikon lirim nga tatimi për të gjitha grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-fitimprurës të OShC-ve. Ligji siguron lehtësira tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve. Ligji siguron lehtësira tatimore për investimet pasive të OShC-ve. Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për fondet investive/të dhurimeve 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ligji siguron lirimin nga tatimi për të gjitha grantet dhe donacionet që përkrahin aktivitetin jofitimprurës të OShC-ve Ligji siguron lehtësime tatimore për aktivitete të ndërlidhura ekonomike të OShC-ve deri në “një nivel të arsyeshëm të të ardhurave” Nuk ka dispozita ligjore specifike për trajtimin e investimeve pasive të OShC-ve Nuk ka dispozita ligjore për themelimin dhe funksionimin e fondeve investive/të dhurimit 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Korniza ligjore duhet të adresojë në mënyrë specifike investimet pasive të OShC-ve Korniza ligjore duhet të rregulloj themelimin dhe funksionimin e fondeve investive/të dhurimit Draft ligji për donacione dhe filantropi duhet ta zgjerojë gamën, përtej kulturës, rinisë dhe

	<p>1) Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet, direkte ose indirekte (e fshehur).</p> <p>2) Lehtësirat tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OShC-ve.</p> <p>3) Investimet pasive shfrytëzohen nga OShC-të dhe nuk aplikohen sanksione për investime të tilla.</p> <p>4) Fondet investive/të dhurimeve krijohen pa vështirësi të mëdha procedurale dhe veprojnë lirisht, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nuk raportohet ndonjë tatim i drejtpërdrejtë apo indirekt në grante Në përgjithësi, lehtësimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC-ve janë efektive, edhe pse ka vështirësi në raportim për shkak të procedurave të raportimit të cilat nuk janë specifike për punën e OShC-ve Investimet pasive të OShC-ve nuk janë të zakonshme dhe vetëm një prej OShC-ve të anketuara ka raportuar të ketë gjeneruar të ardhura nga investimet pasive. Nuk ka praktika të themelimit ose funksionimit të fondeve investive/të dhurimit të cilat funksionojnë në Kosovë 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Procedurat e raportimit të ndërlidhura me lehtësirat tatimore të OShC-ve duhen të marrin parasysh natyrën specifike të punës së OShC-ve

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

Parimi: Përkrahja shtetërore për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
-------------	-----------	-------------	-----------------------------

<p>Financimi publik është në dispozicion për zhvillimin institucional të OShC-ve, për përkrahje të projekteve dhe për bashkëfinancimin e granteve të BE-së dhe të granteve të tjera</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon përkrahjen shtetërore për zhvillimin institucional të OShC-ve, mbështetje për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE. 2) Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OShC-të. 3) Fondet publike për OShC-të planifikohen në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit. 4) Ka procedura të qarta për pjesëmarrjen e OShC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka ligj apo politikë/dokument kombëtar i cili e rregullon përkrahjen shtetërore për OShC-të • Nuk ka mekanizëm të nivelit kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC-të • Fondet publike për OShC-të nuk janë të planifikuara qartë përbrenda buxhetit shtetëror • Ekzistojnë dispozita ligjore për mundësinë e drejtimit të fondeve të lotarisë tek grupe të ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport, mirëpo nuk ekzistojnë procedurat për këtë • Nuk ka procedura për pjesëmarrjen e OShC-ve në ciklin e financimit publik • Këshilli për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile ka përfshirë identifikimin e modelit për financim publike të OShC-ve si një prej prioriteteve për vitin 2015 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të iniciohet një sistem gjithëpërfshirës i financimit publik, bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe Planin e veprimit për vitin 2015
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të shoqërisë civile. 2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose mbikëqyrjen e shpërndarjes së fondeve shtetërore. 3) Financimi është i parashikueshëm, jo i zvogëluar në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shumica e buxhetit për OShC identifikohet lehtë. 4) Pjesëmarrja e OShC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplotë. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Financimi publik është në dispozicion, mirëpo nuk i përgjigjet nevojave të sektorit të OShC-ve • Asnjë trup qeveritar nuk e ka mandatin të shpërndajë dhe monitorojë shpërndarjen e fondeve shtetërore • Financimi nuk është i planifikuar dhe i parashikueshëm dhe është e pamundur të identifikohet shumica e buxhetit për OShC-të • Nuk ekzistojnë informata në lidhje me mbledhjen apo shpërndarjen e fondeve të lotarisë • Nuk ka pjesëmarrje të OShC-ve në ciklin e financimit publik 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Financimi publik për OShC-të duhet të bëhet transparent, pavarësisht sistemit gjithëpërfshirës të financimit publik • Financimi publik për OShC-të duhet të planifikohet paraprakisht dhe të jetë i parashikueshëm në baza vjetore • OShC-të duhen të jenë pjesë e hartimit dhe zbatimit të sistemit gjithëpërfshirës për financimin publik, dhe

			zbatimin e tij
--	--	--	----------------

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.2.: Përkrahja shtetërore

Parimi: Përkrahja shtetërore financiare për OShC-të ofrohet në mënyrë transparente dhe shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme

STANDARDI 2	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
Financimi publik shpërndahet në mënyrë të paraparë dhe transparente	Legjislacioni: <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjërish detyruese për palët. 2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht. 3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje. 	Legjislacioni: <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka procedurë specifike për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC-të • Nuk ka kritere standarde të përzgjedhjes dhe institucione të ndryshme shtetërore përdorin kritere të ndryshme të përzgjedhjes • Të vetmet procedura specifike për OShC-të për adresimin e konfliktit të interesit në lidhje me financimin nga shteti janë të ndërlidhura me zyrtarët publik si anëtarë të bordeve 	Legjislacioni: <ul style="list-style-type: none"> • Një sistem gjithëpërfshirës për financimin publik duhet të iniciohet, duke u bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile • Sistemi gjithëpërfshirës për financimin publik duhet të ketë procedura të qarta për adresimin e konfliktit të interesit

	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Informacioni lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në dispozicion të publikut. 2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar. 3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OShC-të. 4) Vendimet mbi tenderët konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit shpallen paraprakisht. 5) Financimi publik shpërndahet në mënyrë transparente bazuar në konkurrencë të hapur në mes të aplikuesve të pranueshëm. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informatat në lidhje me procedurat dhe projektet e financuara janë në dispozicion publik vetëm në raste të rralla • Trupat shtetërorë nuk kanë procedura të harmonizuara të cilat i zbatojnë Nuk ka informata të mjaftueshme që do të mundësonin vlerësimin dhe raportimin e kërkesave të aplikimit • Shumica e vendimeve për tenderë nuk janë transparente dhe nuk ka informata në dispozicion për drejtësinë e vendimeve dhe konfliktin e interesit • Vetëm një pjesë e vogël e financimit publik shpërndahet në mënyrë transparente bazuar në konkurrencën e hapur në mes të aplikuesve të pranueshëm. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha informatat për financimin publik duhen të jenë publike në mënyrë adekuate dhe në kohë të duhur • Kërkesat e tashme për aplikim duhen të jenë publike në të gjitha rastet • Vendimet për dhënien e fondeve publike duhen të merren nga borde të pavarura, të cilat gjithashtu përfshijnë përfaqësues të OShC-ve
--	--	--	--

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.3: Burimet njerëzore

Parimi: Politikat shtetërore dhe ambienti ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera në OShC

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligji dhe politikat i trajtojnë OShC-të në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • OShC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit tjerë sipas ligjit • OShC-të kanë vështirësi në zbatimin e dispozitave të Ligjit të punës në lidhje me pushimin e lehonisë, për shkak të natyrës së 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i Ligjit të punës duhet të përfshijë OShC-të në mënyrë që të shqyrtohen dhe adresohen zgjidhjet e pushimit të

		tyre specifike të financimit <ul style="list-style-type: none"> Procesi i amendamentimit të Ligjit të punës, i iniciuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në vitin 2013 është pezulluar për shkak të bllokadës institucionale të vitit 2014 	lehonisë për punëtorët e OShC-ve
	Praktika: 1) Nëse ka programe shtetërore për nxitje të punësimit, OShC-të trajtohen njësoj si të gjithë sektorët e tjerë. 2) Ka statistika të rregullta mbi numrin e të punësuarve në sektorin jofitimprurës.	Praktika: <ul style="list-style-type: none"> OShC-të nuk trajtohen nëpër programe punësimi të nxitura nga shteti. Një dokument i politikave për rregullimin e Ndërmarrjeve Shoqërore është iniciuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe disa OShC janë ftuar ti japin komentet e tyre në këtë proces Në përgjithësi nuk ekzistojnë statistika të rregullta për numrin e punëtorëve në sektorin jofitimprurës. Një numër i përgjithshëm i atyre të cilët paguajnë tatime nga sektori jofitimprurës është në dispozicion nga Enti Statistikor i Kosovës me kërkesë, edhe pse nuk është në dispozicion kategorizimi i punëtorëve me orar të plotë, atyre me orar të shkurtër dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm përbrenda këtij numri. 	Praktika: <ul style="list-style-type: none"> Kur bëhet projektimi i politikave të punësimit, shteti duhet njohë shoqërinë civile si një prej sektorëve të cilët gjenerojnë punësim, dhe si rrjedhojë duhet t'i përfshijë OShC-të në programet e punësimit të nxitura nga shteti Enti Statistikor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Administrata Tatimore duhen t'i përfshijnë OShC-të si kategori e statistikave në statistikat e tyre të punësimit dhe t'i publikojnë këto statistika

Fusha 2: Korniza për qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve

Nënfusha 2.3: Burimet njerëzore

Parimi: Politikat shtetërore dhe ambienti ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizmin dhe angazhime të tjera në OShC

STANDARDI 2	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ekzistojnë politika dhe ligje përkrahëse për vullnetarizëm</p>	<p>Legjislacioni:</p> <p>1) Legjislacioni nxit vullnetarizmin dhe përfshin praktikën më të mirë rregullative, duke lejuar në të njëjtën kohë për praktikë spontane vullnetarizmi.</p> <p>2) Ekzistojnë stimuj dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit.</p> <p>3) Ekzistojnë marrëdhënie kontraktuale të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe mbrojtje për vullnetarizmin e organizua.</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Legjislacioni nxit punën vullnetare vetëm për rininë, dhe regjistrimi i vullnetarëve rinor është i obligueshëm • Pothuajse fare s'ka nxitje dhe programe të përkrahura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e punës vullnetare rinore • Ka obligime ligjore për marrëdhëniet kontraktuale dhe mbrojtjen e vullnetarëve të organizuar rinor 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një sistem gjithëpërfshirës për punën vullnetare duhet të iniciohet, bazuar në objektivat e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe me përfshirjen e fushave tjera përtej punës vullnetare
	<p>Praktika:</p> <p>1) Stimujt dhe programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OShC-të, ndërsa politika/dokumenti strategjik/ligji zbatohet plotësisht, mbikëqyret dhe vlerësohet periodikisht në mënyrë pjesëmarrëse.</p> <p>2) Procedurat administrative për organizatorët e aktiviteteve vullnetare ose për vullnetarët nuk janë të komplikuar dhe janë pa ndonjë kosto të panevojshme.</p> <p>3) Vullnetarizmi mund të bëhet në çfarëdo forme, nuk ka raste ankesash mbi kufizimet ndaj vullnetarizmit.</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pothuajse s'ka fare nxitje dhe programe për punën vullnetare rinore, dhe dispozitat për punën vullnetare rinore nuk zbatohen • Një program i vullnetarizmit nga Ministria e Kulturës, rinisë dhe sportit ka angazhuar 99 vullnetarë të ri gjatë 3 viteve dhe u ka dhënë atyre certifikata të cilat shërbejnë për ta bëtë të njohur këtë angazhim si përvojë pune • Një numër i kufizuar i granteve dhe përkrahjes për projekte për vullnetarizmin është siguruar nga Ministria e Kulturës, rinisë dhe sportit. Vetëm 2.4% të OSHC-ve të anketuara kanë dijeni për këtë përkrahje. • Një grup punues në objektivin 4 (Vullnetarizmin) të Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është themeluar dhe i është dhënë mandati të krijoj mundësitë e politikave për përmirësimin e punës vullnetare në sektorin e shoqërisë civile • Procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinor janë të koklavitura 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurat administrative për organizatat nikoqire të vullnetarëve rinorë duhen të thjeshtësohen

		<p>dhe të rënda për OShC-të</p> <ul style="list-style-type: none"> Vullnetarizmi mund të ndodh në çfarëdo forme, pa ndonjë procedurë formale 	
--	--	---	--

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

Parimi: Ekziston një qasje strategjike për të çuar më tej bashkëpunimin në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe për zhvillimin e shoqërisë civile

STANDARDI 2	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Shteti, përmes politikave dhe strategjive, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektorin</p>	<p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ekzistojnë dokumente strategjike që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe zhvillimin e shoqërisë civile.</p> <p>2) Dokumenti strategjik përfshin qëllimet dhe masat, financimin në dispozicion, si dhe ndarje të qartë të përgjegjësive (plane veprimi, përfshirë indikatorët).</p> <p>3) Dokumenti strategjik përfshin masa që janë zhvilluar në konsultim me dhe/ose të rekomanduara nga OShC-të.</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një Strategji qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është miratuar në qershor të vitit 2013, dhe ka filluar zbatimin e saj vetëm në fund të vitit 2014 Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile përfshin masat dhe objektivat strategjike, si dhe planin specifik të veprimit me ndarje të përgjegjësive, Ministria e Financave ka ndarë buxhetin për zbatimin e kësaj Strategjie (137,960 EUR për 4 vite) Masat brenda Strategjisë qeveritare për 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një sistem i monitorimit për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile duhet të themelohet sa më shpejt që të jetë e mundur Kuvendi i Kosovës duhet të ndërtoj mbi bazat e Deklaratës për të krijuar mekanizma konkret të bashkëpunimit dhe

		<p>bashkëpunim me shoqërinë civile janë zhvilluar bashkërisht me OShC-të</p> <ul style="list-style-type: none"> Një Deklaratë për bashkëpunim në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile është miratuar në fillim të vitit 2014, dhe përmbajtja e kësaj deklaratë është hartuar në bashkëpunim me OShC-të aktive në nivel të Kuvendit. 	<p>përfshirjes së OShC-ve në punën e Kuvendit</p>
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> OShC nga fusha të ndryshme marrin pjesë rregullisht në të gjitha fazat e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të dokumentit, strategjik. Ka shembuj që tregojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OShC-ve dhe zhvillimi i shoqërisë civile është përmirësuar dhe zbatohet në përputhje me/ose përtej masave të parashikuara në dokumentin strategjik. Zbatimi i dokumentit strategjik mbikëqyret, vlerësohet dhe rishikohet kohë pas kohe. Politikat shtetërore për bashkëpunim midis autoriteteve shtetërore dhe OShC-ve dhe për zhvillimin e shoqërisë civile janë të bazuara në të dhëna të besueshme të mbledhura nga statistikat kombëtare, duke marrë parasysh larminë e sektorit. 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Shumë OShC nga fusha të ndryshme të interesit kanë marrë pjesë në zhvillimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile Trupat përgjegjës për zbatimin e kësaj Strategjie janë funksionalizuar deri në fund të vitit 2014 dhe zbatimi i saj pritet të iniciohet në vitin 2015. Një Plan i veprimit i detajuar për vitin 2015 është miratuar nga Këshilli për zbatimin e strategjisë Për shkak të moskonstitimit të Kuvendit gjatë pjesë më të madhe të vitit 2014, Deklarata për bashkëpunim në mes të Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile ende nuk ka prodhuar kurrfarë rezultati. Një grup i përbashkët me shoqërinë civile pritet të themelohet në vitin 2015 për projektimin e aktiviteteve specifike për zbatimin e deklaratës. Strategjia qeveritare parasheh monitorim të vazhdueshëm, si dhe vlerësim e rishikim të kohëpaskohshëm. Është planifikuar që sistemi i monitorimit të themelohet gjatë vitit 2015 dhe një shqyrtim është planifikuar të bëhet deri në fund të vitit 2015 Strategjia qeveritare është bazuar në të dhëna të mbledhura kryesisht nga OShC-të 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vullneti politik për zbatimin e duhur të Strategjisë duhet të rritet Një zbatim më dinamik i strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile duhet të iniciohet nga qeveria Duhet të ketë edukim intensiv dhe ngritje të kapaciteteve për nëpunësit civilë lidhur me Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe rolin e tyre në zbatimin e saj Enti Statistikor i Kosovës duhet të bashkëpunojë me OShC-të që merren me zhvillimin e shoqërisë civile në mbledhjen dhe publikimin e të dhënave relevante për sektorin e shoqërisë civile

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nënfusha 3.1.: Korniza dhe praktikat për bashkëpunim

Parimi: Ekziston një qasje strategjike për të çuar më tej bashkëpunimin në mes të autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile dhe për zhvillimin e shoqërisë civile

STANDARDI 2	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Shteti, përmes funksionimit të institucioneve të tij, e njeh rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimin me sektori</p>	<p>Legjislacioni: 1) Ekziston një institucion në nivel kombëtar ose mekanizëm me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (p.sh., Njësia/Zyra për bashkëpunim; pikat e kontaktit në ministri, këshill për bashkëpunim). 2) Ka dispozita të detyrueshme për përfshirjen e OShC-ve në vendimet e marra nga institucioni kompetent apo mekanizmi(at).</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra për qeverisje të mirë e Zyrës së Kryeministrit e ka mandatin ta lehtësoj bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile • Një Këshill për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është themeluar në vitin 2014. Nga 29 anëtarë të këtij Këshilli, 15 prej tyre janë përfaqësues të shoqërisë civile, ku 14 prej tyre janë zgjedhur përmes një procedure të hapur dhe demokratike derisa një është emëruar nga Plaforma CiviKos • Rregullorja e punës së Këshillit e obligon këtë trup që ti marrë parasysh të gjitha iniciativat dhe komentet e pranuar nga OSHC-të, derisa ekzistojnë dispozita të tjera të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile në punën e këtij Këshilli • Një zyrtar i lartë për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe donatorët është pjesë e Sekretariatit të Kuvendit. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra për qeverisje të mirë e Zyrës së Kryeministrit duhet të themelojë një njësi të veçantë për bashkëpunim me shoqërinë civile, me mandat specifik për lehtësimin e bashkëpunimit mes Qeverisë dhe shoqërisë civile

	<p>Praktika:</p> <p>1) Institucioni i nivelit kombëtar apo mekanizmi(at) kanë burime të mjaftueshme dhe mandat për lehtësimin e dialogut Qeveri – shoqëri civile, për të diskutuar sfidat dhe propozuar politikat kryesore për zhvillimin e shoqërisë civile.</p> <p>2) OShC-të konsultohen dhe përfshihen rregullisht në proceset dhe vendimet nga ana e institucionit ose mekanizimit (ave) kompetent.</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gjatë vitit 2014, Zyra për qeverisje të mirë ka punësuar dy zyrtarë për detyra të ndërlidhura me zbatimin e strategjisë. Ende mbetet të vlerësohet se a do të krijoj kjo kapacitetet e nevojshme për të shërbyer si sekretariat plotësisht funksional i Këshillit dhe për t'i përfunduar të gjitha detyrat për zbatimin e strategjisë. 61.5% të OSHC-ve të anketuara deklarojnë se nuk kanë bashkëpunuar me ZQM derisa 33.3% të OSHC-ve të anketuara kanë deklaruar se kanë marrë pjesë nëpër seanca informative apo takime konsultative të organizuara nga ZQM-ja Aktivitetet e ndërlidhura me zbatimin e strategjisë gjithmonë përfshijnë dhe konsultohen me OSHC-të Zyrtari i lartë për bashkëpunim me donatorët dhe shoqërinë civile i Kuvendit të Kosovës ende nuk ka krijuar ndonjë përmirësim të madh në marrëdhëniet në mes të shoqërisë civile dhe Kuvendit. 70% e OSHC-ve të anketuara deklarojnë se nuk kanë pasur kurrfarë bashkëpunimi apo edhe se nuk kanë dëgjuar fare për zyrtarin e shoqërisë civile në Kuvend, ku pjesa tjetër kanë deklaruar nivele dhe forma të ndryshme të bashkëpunimit 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Zyra për qeverisje të mirë duhet ta rritë cilësinë e përmbushjes së detyrave të saj si Sekretariat i Këshillit dhe detyrave tjera në zbatimin e kësaj strategjie
--	---	--	--

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nënfusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes

Parimi: OShC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe në vendimmarrje

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Ekzistojnë standardet që mundësojnë përfshirjen e OShC-ve në vendimmarrje, që ua mundëson atyre dhënien e komenteve dhe kontributit me kohë</p>	<p>Legjislacioni:</p> <p>1) Ekzistojnë standarde të përcaktuara qartë për përfshirjen e OShC-ve në proceset vendimmarrëse dhe të hartimit të politikave, në përputhje me praktikën më të mira rregullatore që përshkruajnë kërkesat minimale që çdo proces politikë-bërës duhet të përmbushë.</p> <p>2) Politikën shtetërore parashikojnë programe edukative/ trajnime për nëpunësit civilë për përfshirjen e OShC-ve në punën e institucioneve publike.</p> <p>3) Rregulloret e brendshme kërkojnë që njësi të specifikuar ose zyrtarë në Qeveri, ministritë e linjës apo agjenci të tjera qeveritare të koordinojnë, monitorojnë dhe raportojnë përfshirjen e OShC-ve në punën e tyre.</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e punës e Qeverisë kërkon konsultime publike për të gjitha draftet politikë/ligjet, përderisa kërkesat minimale priten të miratohen gjatë vitit 2015. • Ligji për vetëqeverisje lokale parashihet instrumente të pjesëmarrjes së qytetarëve në nivelin lokal të vendimmarrjes • Rregullorja e Punës e Kuvendit siguron mundësi të padetyrueshme për përfshirjen e OShC-ve në punën e komisioneve parlamentare • Edhe pse janë pjesë e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, nuk është inicuar asnjë program edukativ/trajnim për shërbyesit civil për përfshirjen e OShC-ve deri më tani. Ngjashëm, Instituti Kosovar i Administratës Publike nuk ka module për konsultimin publik e as për bashkëpunimin me shoqërinë civile • Me përjashtim të zyrtarëve/zyrave të përgjithshme për bashkëpunim në qeveri dhe Kuvend, ministritë e linjës dhe institucionet tjera publike nuk kanë rregullore të brendshme të cilat kërkojnë nga njësi/zyrtarë specifik të bëjnë koordinimin, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes së OShC-ve në punën e tyre 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Akti normativ për standardet minimale për konsultime publike në nivelin e qeverisë duhet të miratohet dhe zbatohet • Kërkesat për përfshirjen e OShC-ve duhet të përfshijnë të tërë ciklin e vendimmarrjes, duke filluar nga caktimi i agjendës e deri te riformulimi • Kuvendi duhet të hartojë kërkesa detyruese për përfshirjen e OShC-ve në punën e Komisioneve Parlamentare • Institucionet publike duhet të emërojnë njësitë/zyrtarët specifik për përfshirjen e OShC-ve, si dhe të projektojnë programe për ngritjen e kapaciteteve për stafin e tyre

	<p>Praktika:</p> <p>1) Institucionet publike në mënyrë rutinore ftojnë të gjitha OShC-të e interesuara për të komentuar mbi politika/nisma ligjore, në një fazë të hershme.</p> <p>2) OShC-ve u ofrohet informacion adekuat për përmbajtjen e draft dokumenteve dhe detajet e konsultimeve, me kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur.</p> <p>3) Institucionet publike bëjnë publike informacione të shkruara mbi rezultatet e konsultimeve, duke përfshirë arsyet përse disa rekomandime nuk janë përfshirë.</p> <p>4) Shumica e nëpunësve civilë të ngarkuar me hartimin e politikave publike kanë përfunduar me sukses programet e nevojshme arsimore/trajnuese.</p> <p>5) Shumica e njëjësive/zyrtarëve që merren me koordinimin dhe mbikëqyrjen e konsultimeve publike janë funksionale dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm.</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet publike, sidomos ministritë, në shumë raste i ftojnë OShC-të të paraqesin komente me shkrim për draftligjet/politikat, edhe pse jo në fazat e hershme të hartimit. • Shumica e komunave nuk e përfshijnë shoqërinë civile rregullisht dhe shumë prej instrumenteve ligjore për pjesëmarrje nuk janë funksionalizuar si duhet. • Kuvendi i Kosovës nuk ka funksionuar gjatë pjesës më të madhe të vitit 2014; përndryshe në rrethana normale Komisionet parlamentare organizojnë dëgjime publike vetëm për disa draftligje që janë në proces. • OShC-ve rrallë u jepen informata adekuate në lidhje me përmbajtjen e draftdokumenteve, dhe koha e zakonshme për t'iu përgjigjur ftesave ministrore është 15 ditë pune • Rastet janë të rralla kur informatat kthyesë me shkrim për rezultatet e konsultimeve jepen apo vihen në dispozicion të publikut • Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare, shumica e OShC-ve të anketuara mendojnë se një numër i vogël i nëpunësve civilë përgjegjës për hartimin e politikave publike kanë mbaruar ndonjë program edukimi/trajnimi për përfshirjen e OShC-ve <p>Nuk ka njësi/zyrtar të cilët koordinojnë dhe monitorojnë konsultimet publike</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministritë duhet t'i ftojnë OShC-të të paraqesin komente me shkrim qysh në fazat e hershme të hartimit të dokumenteve • Ministritë duhen ta përdorin formatin e rekomanduar për konsultime me shkrim, me informata adekuate për përmbajtjen e draft dokumentit • Komisionet parlamentare duhet të organizojnë dëgjime publike për të gjitha draft ligjet në proces • Obligimi për informata kthyesë duhet të zbatohet nga qeveria • Qeveria duhet të bashkëpunojë me shoqërinë civile në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civilë në përfshirjen e OShC-ve
--	--	---	--

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nënfusha 3.2: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe në vendimmarrje

Parimi: OShC-të janë të përfshira në mënyrë efektive në procesin e hartimit të politikave dhe në vendimmarrje

STANDARDI 3	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
<p>Përfaqësuesit e OShC-ve janë partnerë të barabartë në trupat ndërsektoralë dhe zgjedhen përmes kriterëve dhe proceseve të përcaktuara qartazi</p>	<p>Legjislacioni:</p> <p>1) Legjislacioni ekzistues kërkon që institucionet publike të ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve në trupa të ndryshme vendim-marrëse dhe/ose këshilluese të krijuara nga institucionet publike.</p> <p>2) Ka udhëzime të qarta se si të sigurohet përfaqësimi i duhur nga shoqëria civile, bazuar në kriterë transparente dhe të paracaktuara.</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Legjislacioni ekzistues i lejon por nuk i obligon institucionet publike t'i ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve nëpër trupa këshillues apo vendimmarrës të krijuara nga institucionet publike • Nuk ka mekanizma për përzgjedhje apo udhëzues standard të përzgjedhjes së përfaqësuesëve nga shoqëria civile. Disa trupa, përdorin mekanizma përzgjedhës të krijuar për nevoja specifike të këtyre trupave 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e punës e Qeverisë dhe Ligji për vetëqeverisje lokale duhet të ndryshohet që t'i obligojë institucionet publike t'i ftojnë përfaqësuesit e OShC-ve nëpër trupa vendimmarrës/këshillëdhënës • Duhet projektuar mekanizma të përgjithshëm të përzgjedhjes nga Qeveria, për t'u mundësuar pastaj të gjitha institucioneve publike t'i aplikojnë ato me përshtatje specifike
	<p>Praktika:</p> <p>1) Trupat vendim-marrëse dhe këshilluese për çështjet dhe politikat që lidhen me shoqërinë civile në përgjithësi përfshijnë përfaqësuesit e OShC-ve.</p> <p>2) Përfaqësuesit e OShC-ve në këto trupa kanë mundësi të paraqesin lirisht dhe të mbrojnë pozicionet e tyre, pa u sanksionuar.</p> <p>3) Përfaqësuesit e OShC-ve përzgjedhen përmes proceseve të cilat konsiderohen të jenë të drejta dhe transparente.</p> <p>4) Pjesëmarrja në këto trupa nuk i ndalon OshC -të të përdorin mënyra alternative të avokimit ose promovimin e qëndrimeve alternative të cilat nuk janë</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka një numër të trupa vendimmarrës dhe këshillëdhënës të cilët i përfshijnë përfaqësuesit të OShC-ve për çështje të ndryshme • Përfaqësuesit e OShC-ve nëpër këta trupa në përgjithësi janë të lirë t'i prezantojnë dhe mbrojnë qëndrimet e tyre, pa u sanksionuar • Vetëm një numër i vogël i trupave këshilluese dhe vendimmarrëse i kanë përzgjedhur përfaqësuesit nga OShC-të përmes një procesi të hapur të përzgjedhjes , siç është Këshilli për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ftesa dhe përzgjedhja e përfaqësuesve të OShC-ve nëpër trupa vendimmarrës dhe këshillues duhet të jenë transparente dhe publike në të gjitha rastet • Modeli i përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e strategjisë do të merret parasysh për përshtatje për

	në përputhje me pozicionin e trupit përkatëse.	<ul style="list-style-type: none"> OShC-të që marrin pjesë nëpër trupa vendimmarrës dhe këshillues në përgjithësi përdorin edhe mënyra tjera të avokimit të cilat nuk janë patjetër në përputhje me pozicionin e trupit përkatës 	të gjithë trupat vendimmarrës dhe këshillëdhënës
--	--	---	--

Fusha 3: Bashkëpunimi Qeveri – shoqëri civile

Nënfusha 3.3: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Parimi: Ekziston një ambient i favorshëm për përfshirjen e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve

STANDARDI 1	TREGUESIT	TË GJETURAT	REKOMANDIMET PËR STANDARDIN
OShC-të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata shtetërore në baza të barabarta me ofruesit e tjerë të shërbimeve	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni ekzistues lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme si arsimit, shëndetësia, shërbimet sociale. OShC-të nuk kanë pengesa për të ofruar shërbime të cilat nuk janë të përcaktuara me ligj (shërbime "shtesë"). Legjislacioni ekzistues nuk rëndon OShC-të me kërkesa shtesë të cilat nuk ekzistojnë për ofruesit e tjerë të shërbimeve. 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Legjislacioni i përgjithshëm lejon OShC-të të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme, ndërsa legjislacioni specifik lejon që OShC-të të ofrojnë shërbime sociale Ekzistojnë barrierat e fshehta ligjore në legjislacionin e përgjithshëm të cilat në disa raste parandalojnë OShC-të të jenë të përshtatshme për kontrata të ofrimit të shërbimeve (p.sh. kërkesa e certifikatës së regjistrimit të biznesit) 	<p>Legjislacioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ligji për prokurimin publik duhet të ndryshohet që të lejoj certifikatat e regjistrimit të OJQ-ve të pranohen njëjtë si edhe certifikatat e regjistrimit të biznesit Sistemi i ofrimit të shërbimeve duhet të reformohet dhe të hapet

		<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka kërkesa ligjore shtesë për OShC-të në krahasim me ofruesit tjerë të shërbimeve, edhe pse kërkesat e përgjithshme nuk janë në pajtim me natyrën specifike të punës së OShC-ve, me përjashtim të ofrimit të shërbimeve sociale ku natyra specifike e punës së OShC-ve është pjesë e legjislacionit 	<p>për OSHC në të gjitha sektorët, siç kërkohet nga strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile</p>
	<p>Praktika:</p> <p>1) OShC-të janë në gjendje të përfitojnë kontrata në konkurrencë me ofruesit e tjerë dhe janë të angazhuar në shërbime të ndryshme (p.sh. në fushën e arsimit, shëndetësisë, hulumtimit dhe trajnimeve).</p> <p>2) OShC-të janë të përfshira në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve (vlerësimin e nevojave, përcaktimin e shërbimeve që adresojnë më mirë nevojat, monitorim dhe vlerësim).</p> <p>3) Në rastet kur kërkohet regjistrim/licensim, procedura për marrjen e licensës nuk është tepër e rëndë.</p>	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ka pak OShC të cilat janë në gjendje të marrin kontrata, kryesisht në shërbime sociale dhe fusha ku nuk ekzistojnë ofrues tjerë të shërbimeve OShC-të janë të përfshira në disa faza të zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve Regjistrimi dhe licencimi kërkohet për të gjitha shërbimet sociale, dhe procedura për t'i marr këto është e njëjtë me ofruesit tjerë të shërbimeve. Bazuar në një numër të standardeve strukturale dhe profesionale të caktuara kohëve të fundit, licencimi i individëve ka filluar, derisa licencimi i OSHC-ve të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare pritet të filloj gjatë vitit 2015. Decentralizimi i shërbimeve sociale është pajtuar në mes të niveleve qendrore dhe lokale, mirëpo ende nuk është raportuar për ndonjë rezultat konkret nga ky proces 	<p>Praktika:</p> <ul style="list-style-type: none"> OShC-të duhet të përfshihen në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve Baza e re ligjore për licencimin e shërbimeve sociale dhe të ofruesve të tyre duhet të jetë në përputhje me parimet e parapara në Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Burimet e përdorura dhe faqe të dobishme

- Kushtetuta e Kosovës
- 04/L-082 Kodi penal i Republikës së Kosovës
- Ligji civil 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes
- Ligji 04/L-57 për lirinë e asociimit në OJQ
- Ligji 04/L-57 për lirinë e asociimit në OJQ
- Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (përfshirë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L 222)
- Ligji 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe të financimit të terrorizmit (përfshirë Ligjin nr. 04/L-178 për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-196)
- Ligji 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave (përfshirë Ligjin 04/L-103 për ndryshimin e Ligjit 03/L-162)
- Ligji 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale (përfshirë Ligjin 04/L-104 për ndryshimin e Ligjit 03/L-161)
- Ligji 03/L-118 për tubimet publike
- Ligji 04/L-109 për komunikime elektronike
- Ligji 03/L-212 i punës
- Ligji 03/L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë
- Ligji për buxhetin 2013
- Ligji 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik
- Ligji 04/L-042 për prokurimin publik
- Ligji 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës
- Ligji 04/L-045 për partneritet publiko-privat
- Ligji 03-L/040 për vetëqeverisjen lokale
- Ligji 03/L-215 për qasje në dokumente publike
- Ligji 02/L-17 për shërbime sociale dhe familare
- Ligji 03/L-049 për financat e pushtetit lokal
- Ligji 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë
- Ligji 04/L-025 për nisma legislative
- Vendim shpjegues publik nr. 03/2013 për trajtimin tatimor të furnizimeve dhe importeve kur financohen drejtpërdrejtë nga BE-ja
- Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive
- Rregullorja nr. 09/2011 e punës së Qeverisë
- Rregullorja e Kuvendit
- Udhëzimi administrativ nr. 10/2010 për punën vullnetare të të rinjëve
- Udhëzimi administrativ 08/ 2010 për zbatimin e Ligjit 03/L- 162 për tatimin në të ardhurat e korporatave

- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2010 për edukimin joformal të të rinjëve
- Udhëzim Administrativ Nr. 04/2011 për ofrimin dhe sigurimin e përkrahjes financiare të OJQ-ve vendore gjatë vitit 2011
- Udhëzim administrativ nr. 2008/09 për transparencë në komuna
- Udhëzim administrativ Nr. 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna
- Udhëzimi administrativ QRK – nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve
- Regjistri i Departamentit për regjistrimin e OJQ-ve
- Raportet vjetore të Avokatit të Popullit për vitin 2013
- Kodi i mediave të shtypura të Kosovës
- Raportet për regjistrimin e popullsisë nga Enti Statistikor i Kosovës për vitin 2012
- Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile
- Raporti vjetor i qeverisë për qasje në dokumente publike 2012
- Raporti vjetor për të drejtat për qasje në dokumente publike për vitin 2013, Zyra e Kryeministrit 2014
- Raporti Ex-officio i Avokatit të Popullit nr. 28/2012 lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar të vitit 2012
- Raporti vjetor i Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2012
- Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për statistika të gjykatave të rregullta për vitin 2012
- Raporti i Freedom House "Freedom in the World" për Kosovën
- Raporti i Organizatave të Mediave të Europës Juglindore (SEEMO) për Kosovën,
- Raportet e Civil Rights Defender,
- Rekomandimi CM/Rec(2007)14 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Europë
- Konventa Europiane për të drejtat e njeriut
- Raportet e Asociacionit të Gazetarëve Profesionist të Kosovës
- Depërtimi dhe përdorimi i Internetit në Kosovë - Shoqata Kosovare për Teknologji të Informimit dhe Komunikimit (STIKK) 2013
- Raporti i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë për Monitorimin e telekomunikacionit
- Deklaratat Financiare të Fondacionit IPKO për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor të vitit 2012 (raporti i auditimit)
- Indeksi i transparencës 2012 për institucionet publike në Kosovë, Lëvizja Fol
- Regjistri Statistikor i Bizneseve 2013, Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Pulsi Publik i UNDP, Vëllimi VIII, Nëntor 2014
- UNDP, Raporti për zhvillim njerëzor 2008, Shoqëria civile & zhvillimi
- KCSF-CIVICUS, Indeksi i shoqërisë civile, Raporti analitik për Kosovën 2011, Qëverisje më e mirë për ndikim më të madh, ftesë për qytetarët
- Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2013, KCSF 2014

Shtojca 1 – Lista e të intervistuarve

Sipas rendit alfabetik:

1. Arhim Ajazi, Komuna e Prizrenit
2. Albert Krasniqi, KIPRED
3. Bajram Kosumi, Ministria e Administratës Publike
4. Bujar Haziri, Komuna e Gjilanit
5. Blerim Krasniqi, Dogana e Kosovës
6. Donika Gashi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
7. Enis Spahiu, Ministria e Financave
8. Engelbert Zefaj, Komuna e Pejës
9. Flutura Blakçori, Njësia e Inteligjencës Financiare
10. Faton Morina, Instituti i Avokatit të Popullit në Kosovë
11. Hajriz Koca, Komuna e Skenderajt
12. Irfan Qajani, Komuna e Hanit të Elezit
13. Kaltrina Sylejmani, Komuna e Vitisë
14. Leunora Ahmeti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
15. Miranda Mullafazliu, Komuna e Prishtinës
16. Meriton Ferizi, Komuna e Gjakovës
17. Muhamet Kastrati, Agjencia e Statistikave të Kosovës
18. Muhamet Gjocaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
19. Petrit Balijs, Shoqata e Bankave të Kosovës
20. Sami Salihu, Administrata Tatimore e Kosovës
21. Shqipe Krasniqi, Kuvendi i Republikës së Kosovës
22. Shpend Emini, D4D
23. Trendelina Dreshaj, Zyra për qeverisje të mirë
24. Teuta Kuqi Maloku, Instituti Kosovar për Administratën Publike
25. Valbona Salihu, NORMA
26. Valdete Krasniqi, Doganat e Kosovës

Shtojca 2 – Pyetjet e intervistave

Administrata Tatimore e Kosovës

- A ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacioni/praktikat e raportimit për OJQ-të ndaj Administratës Tatimore të Kosovës? Nëse po, cilat janë ato ndryshime?
- A ka ndonjë rast të investimeve pasive apo fondeve investive/të dhurimeve në Kosovë për të cilat jëni në dijeni ju?
- A ka ndonjë udhëzues për procedurat e raportimit për OJQ-të? A keni mbajtur ndonjë trajnim për inspektorët tatimore për adresimin e specifikave të OJQ-ve gjatë punës së tyre?

Ministria e Administratës Publike – Departamenti i OJQ-ve

- Cilat janë implikimet praktika të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ për OJQ-të? Cila është baza ligjore për nenin 18?
- A e keni hartuar Rregulloren për funksionimin e Komisionit për shpërndarjen e aseteve të mbetura të OJQ-ve të shuara? A ka pasur ndonjë rast ku ky Komision është themeluar dhe funksionalizuar?
- Cilat janë zhvillimet kryesore të lidhura me iniciativën tuaj për ta ndryshuar Ligjin për OJQ dhe për ta harmonizuar me Ligjin kundër terrorizmit?

Zyra Ligjore – Zyra e Kryeministrit³⁹

- Cilat janë implikimet praktika të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ për OJQ-të? Cila është baza ligjore për nenin 18?
- A ka buxhet të ndarë për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile? Nëse po, sa është shuma totale?
- A kanë fillur të zbatohen aktivitetet e Objektivës 4 – Vullnetarizmi?
- A ka mbajtur qeveria ndonjë trajnim për nëpunësit civil për zbatimin e strategjisë? Si i vlerësoni kapacitetet e tyre për të mbajtur dhe udhëhequr procese të konsultimit publik, ashtu siç kërkohet nga Rregullorja e qeverisë dhe Udhëzimet për konsultime publike? A ka mbajtur ndonjë trajnim për zyrtarët ligjor për procesin e konsultimit publik?
- A kërkoni nga zyrtarët ligjor udhëheqës ti vlerësojnë kontributet e pranuar përbrenda procesit të konsultimit publik dhe ndarjen e vlerësimit me palët të cila i kanë bërë komentet?
- A ka ndonjë ndryshim në mandatin e Zyrës për Qeverisje të Mirë? Nëse po, cilat janë ato ndryshime specifike sa i përket lehtësimit të bashkëpunimit me OSHC? A ka ndonjë punëtorë të caktuar i cili do të ngarkohej me këtë bashkëpunim?
- Cilat janë zhvillimet kryesore në hartimin e standardeve minimale për procesin e konsultimit publik?
- A ka ndonjë zyrtar/njësi përgjegjëse (përbrenda Ministrive) i cili është mandatuar me bashkëpunim, monitorim dhe raportim për procesin e konsultimit publik?
- Si i fotni OSHC-të dhe cilat janë mekanizmat e përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile nëpër trupa këshilldhënës të qeverisë?

³⁹ Hulumtuesit e KCSF nuk kanë qenë në gjendje të caktojnë një intervistë apo të pranojnë përgjigje me shkrim nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, përkundër tentimeve të shumta.

Zyra për qeverisje të mirë – Zyra e Kryeministrit

- A kanë filluar të zbatohen aktivitetet e Objektivës 4 – Vullnetarizmit?
- A ka buxhet të ndarë për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile? Nëse po, sa është shuma totale?
- A ka mbajtur qeveria ndonjë trajnim për nëpunësit civilë për zbatimin e strategjisë dhe rritjen e kuptimit të saj për sektorin e shoqërisë civile?
- A ka ndonjë ndryshim në mandatin e Zyrës për qeverisje të mirë? Nëse po, cilat janë ato ndryshime specifike sa i përket lehtësimit të bashkëpunimit me OShC-të? A ka ndonjë punëtor të caktuar, i cili do të ngarkohej me këtë bashkëpunim? Nëse po, cilat do të jenë detyrat specifike të stafit të punësuar? A kanë ata ndonjë përvojë paraprake të punës me OJQ?
- A i keni emëruar pikat e kontaktit për zbatimin e Strategjisë nëpër ministri të linjës?
- Si i ftoni OShC-të dhe cilat janë mekanizmat e përzgjedhjes së përfqësuesve të shoqërisë civile nëpër trupa këshilldhënës të Qeverisë?
- A ka ndonjë shembull të zbatimit të ndonjë mase/aktiviteti specifik të strategjisë?

Ministria e Financave

- Cilat janë zhvillimet kryesore për fonde publike për OShC?
- Sa është shuma e fondeve të ndara tek OShC-të nga Buxheti i Kosovës gjatë vitit 2014?
- Në cilat procedure bazoheni kur bëhet ndarja e këtyre fondeve? A i publikoni grantet/kontratat e dhëna?
- A ka alokime buxhetore për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile? Nëse po, cila është shuma totale? Nëse po, sa kanë qenë shpenzimet gjatë vitit 2014?
- A ka alokime buxhetore për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile? Nëse po, cila është shuma totale? Nëse po, sa kanë qenë shpenzimet gjatë vitit 2014?
- A ka pas ndonjë ndryshim në Ligjin për prokurimin publik?
- Cili është interpretimi juaj i nenit 65.4.11 të Ligjit për prokurim publik, i cili thotë certifikata e vetme e cila pranohen është certifikata e biznesit? A i ndalon kjo OJQ-të në tender dhe në fitim të kontratave nga fondet publike? Cila është baza ligjore për kontraktimin e OJQ-ve? A ka ndonjë plan për ta amandamentuar Ligjin për prokurim publik dhe/ose për ta adresuar këtë çështje?

Njësia e Inteligjencës Financiare

- Cilat janë zhvillimet e fundit në ndryshimin e Ligjit kundër terrorizmit? Cilat janë ndryshimet kryesore të ndërlidhura me OJQ që janë planifikuar?
- Sa është numri i OJQ-ve të cilave u duhet leja paraprake për pranimin/shpërndarjen e fondeve, sipas neneve 24.1 dhe 24.2? A ka ndonjë sanksion që aplikohet për OJQ të cilat nuk i respektojnë këto kërkesa?

Dogana e Kosovës

- A ka ndonjë ndryshim në legjislacionin doganor për OJQ? A ka ndonjë ndryshim në praktikën e punës?

Institucioni i Avokatit të Popullit

- A ka ndonjë rast të raportuar të kufizimit të të drejtës për tu tubuar për OJQ? Nëse po, a mund të na jepni detajet?

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Cilat janë procedurat për financim të OJQ-ve? A i publikoni grantet e dhëna? Cilat janë linjat buxhetore për këto fonde?
- Cilat janë procedurat për njohjen e punës vullnetare? A janë të implementuara këto procedura? Cilat janë përfitimet për vullnetarët e ri? A është funksional sistemi i regjistrimit të vullnetarëve të ri? Si funksionin? Sa vullnetarë i keni regjistruar?
- A jeni në dijeni për ndonjë program tjetër (përveç atij në Ministrinë tuaj) i cili promovon punën vullnetare?
- A keni caktuar ndonjë zyrtar për bashkëpunim me shoqërinë civile?

Komunat

- A keni siguruar ndonjë fond për OJQ-të gjatë vitit 2014? Nëse po, cila është shuma? Nëse po, cilat janë kriteret e përzgjedhjes? Si është marrë vendimi? A raportojnë këto OJQ për fonde publike? A keni ndonjë model të raportimit? Cila është linja buxhetore për këto fonde?
- A keni caktuar ndonjë zyrtar për bashkëpunim me shoqërinë civile?

OSHC-të

- A ballafaqoheni me ndonjë vështirësi në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për lehoninë?
- A ballafaqoheni me ndonjë vështirësi në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit kundër terrorizmit?
- A jeni në dijeni për ndonjë zhvillim përbrenda Kuvendit të Kosovës në bashkëpunim me shoqërinë civile? A keni qasjen në punën e Komisioneve parlamentare? A mbahen dëgjime publike për secilin ligj që është në procedurë? A keni vërejtur ndonjë efekt nga puna e zyrtarit për shoqërinë civile të Kuvendit të Kosovës?

Agjencia Statistikore e Kosovës

- A ka ndonjë statistikë specifike për OJQ-të? A ka ndonjë statistikë për numrin e të punësuarëve në këtë sektor?

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Cila është faza e tashme e procesit të amandamentimit të Ligjit të punës? Cilat janë ndryshimet e pritura?
- A keni ndonjë program për gjenerim të punësimit? A janë OShC-të pjesë e këtij programi?
- A e keni përshtatur Udhëzimin administrativ për licencimin e shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve?

Instituti Kosovar për Administratën Publike

A keni ndonjë modul të trajnimit/kurrikulë për procesin e konsultimeve publike? A ka ndonjë iniciativë për zhvillimin e një moduli/kurrikule të tillë?

Shtojca 3 – Pyetëtori i hulumtimit të organizatave

Pyetja 1: Emri i organizatës:

Pyetja 2: Emri dhe mbiemri i të anketuarit:

Pyetja 3: Pozita në organizatë e të anketuarit:

Pyetja 4: Dy fushat kyçe të punës së organizatës:

Pyetja 5: Vendndodhja e organizatës (qyteti/komuna):

Pyetja 6: Numri i telefonit:

Pyetja 7: Adresa elektronike e organizatës:

Pyetja 8: Numri i stafit të punësuar në organizatë (shënojeni numrin):

Pyetja 9: A ka ndërhyrë shteti (drejtpërdrejt apo tërthorazi) në çështjet e brendshme të organizatës tuaj (p.sh. auditime të tepërta, inspektime të shënjestruara, presione, etj.):

Pyetja 10: Gjatë vitit 2014, a keni pasur ndonjë vizitë nga ndonjë trup/autoritet inspektues?

Pyetja 11: Sipas masave shtetërore kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, obligimet e OJQ-ve janë:

Pyetja 12: A merret organizata juaj me aktivitetet ekonomike drejtpërdrejtë, dhe nëse po, a paraqesin rregulloret për këto aktivitete ndonjë vështirësi?

Pyetja 13: A pranon organizata juaj fonde nga ndonjë korporatë private, ndonjë individ privat ose prej kompanive?

Pyetja 14: Cila ka qenë arsyeja për pranimin e fondeve nga:

Pyetja 15: Nga cili stimul ka përfituar organizata juaj gjatë vitit 2014 (rrumbullaksoni të gjitha që janë të aplikueshme)?

Pyetja 16: A e ka organizata juaj Statusin për Përfitim Publik?

Pyetja 17: Gjatë vitit 2014, a keni pasur ndonjë kufizim nga shteti në organizimin e tubimeve/protestave të qeta?

Pyetja 18: A gjeneron organizata juaj të ardhura nga investimet pasive? (Të ardhura nga investimet pasive konsiderohen ato të ardhura që gjenerohen nga asetet e organizatës në të cilat organizata nuk ka përfshirje

aktive në menaxhimin e tyre (me fjalë të tjera qiraja, dividendet nga pronësia e një shoqërie aksionare, kamatë nga depozitat bankare, etj.)

Pyetja 19: A gjeneron organizata juaj të ardhura nga fondet investive? (fondet investive paraqesin investimin e aseteve/kapitalit të organizatës, ku organizata operon vetëm përmes të ardhurave të gjeneruara nga ky investim)

Pyetja 20: Si do ta vlerësonit disponueshmërinë e fondeve publike/shtetërore për përkrahje për shoqërinë civile në Kosovë?

Pyetja 21: Si do ta vlerësonit shpërndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile?

Pyetja 22: Në fushën tuaj të aktiviteteve, a ka ftesa për propozime të rregullta (së paku një herë në vit) nga trupat relevante shtetërore për fonde publike?

Pyetja 23: A ju konsultojnë institucionet publike relevante gjatë procesit të vendimmarrjes për prioritetet për fonde publike?

Pyetja 24: A ka përfituar organizata juaj nga fondet publike gjatë vitit 2014?

Pyetja 25: Në rast kur ju keni aplikuar për fonde publike, procesi i aplikimit ka qenë:

Pyetja 26: A janë publikuar rezultatet përfundimtare të procesit (përfituesit e fondeve, emri dhe shumat e projektit, etj)?

Pyetja 27: sipas vlerësimit tuaj, sa nxitëse janë politikat qeveritare të drejtuara kah punësimi në sektorin e shoqërisë civile?

Pyetja 28: A jeni në dijeni për ekzistencën e ndonjë programi shtetëror në përkrahje të vullnetarizmit?

Pyetja 29: Bashkëpunimi me zyrat qeveritare për shoqërinë civile është:

Pyetja 30: Si do të vlerësonit standardin e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e hartimit të ligjeve dhe politikave?

Pyetja 31: Si do ta vlerësonit nivelin e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes?

Pyetja 32: Gjatë vitit 2014, a është angazhuar organizata juaj në hartimin e një politike publike, apo rregulloreje komunale?

Pyetja 33: Shënoni të gjitha ligjet/politikat/strategjitë/aktet tjera në hartimin e të cilave organizata juaj ka marrë pjesë në mënyrë aktive (konsultime, grupe pune, tryeza të rumbullakta të organizuara nga institucionet relevante, etj.):

Pyetja 34: Si jeni informuar në lidhje me fillimin e procesit të hartimit të një ligji/politike (rumbullaksoni të gjitha përgjegjet e aplikueshme)

Pyetja 35: Gjatë konsultimit, në çfarë forme i keni pranuar draftligjet/politikat:

Pyetja 36: A ju ka kontaktuar ministria pas pranimit të komenteve tuaja:

Pyetja 37: Pjesëmarrja juaj në përgatitjen e ligjeve/politikave ka qenë:

Pyetja 38: Si do ta vlerësonit pjesëmarrjen e shoqërisë civile nëpër trupa ndërsektoral?

Pyetja 39: Sa shpesh komunikoni (shkëmbeni informata/dokumente, aktivitete të përbashkëta, takime, etj.) me institucionet publike relevante për aktivitetet tuaja?

Pyetja 40: A ofron organizata juaj shërbime për një grupë të caktuar të përfituesve (përfshijë shërbimet komerciale dhe këshilldhënëse)

Pyetja 41: Si do ti vlerësonit procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike të OSHC-të?

Pyetja 42: Organizata juaj ofron shërbime:

Pyetja 43: Organizata juaj mbulon shpenzimet për ofrimin e shërbimeve me:

Pyetja 44: A është e koklavitur procedura për regjistrim/licencim për ofrim të shërbimeve?

Pyetja 45: Shërbimet publike rregullohen përmes:

Pyetja 46: A ka qenë e përfshirë organizata juaj në të gjitha fazat e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve publike (vlerësimi të nevojave, zbatimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit?)